


URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.141 DHJETOR 2020



**Viti i Naimit ,
në selinë e shenjtë
bektashiane**



Faqe 9



**Kremtohet ditëlindja e
Profetit Muhamed a.s.**

Faqe 4

**Tre takime në një ditë
për "Viti i Naimit"**



Faqe 11


**Kryegjyshi Botëror
Bektashian, Hirësia e Tij,
Haxhi Dede Edmond Brahimaj,
në Parlamentin e Kosovës**



Faqe 23

URTËSIA

REVISTË FETARE SHQËRIMORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEQJVSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.141 DHJETOR 2020



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni

Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Ali Spahiu - Zvicër

Përparim Kapllani - Kanada

Eliton Pashaj - SHBA

Agim Cani - Gjermani

Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka

Zenel Anxhaku

Blerina Harizaj

Agim Zeka

Xhevdet Shehu

DESIGN

StudioGraf "AN"

SHTYPET NË SHTYPSHKRONJËN

"Urtësia
Bektashiane"

Dhjetor, 2020

Islami: Thirrje për një familje të lumtur



Çojmë përpjekjet tuaja për paqe!



Gjithë bota islame kremtoi këto ditë Profetin Muhamed, udhëheqësin shpirtëror të tyre... Përkujtoi profetin që e shpalli fenë e Zotit, jo si shumë profetë të tjerë, që ua shpallën fenë vetëm popujve të tyre, por për gjithë njerzimin mbarë.

Më ftesë të z. Jean-Christophe Peaucelle, Ambasador për Çështjet Fetare në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme të Francës, në datën 8 tetor, në mjediset e kësaj Ministrie, delegacioni i Selisë së Shenjtë Bektashiane, i kryesuar nga Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u takua me miqtë francezë.

Naimi ynë, bektashiu i ndritur

Jubileu i 120 vjetorit të kalimit nga jeta të Naim Frashërit, ka mbledhur në mjesdiset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, më 20 Tetor 2020, personalitete të ndryshëm letrarë, përfaqësues të feve në Shqipëri, përfaqësues të ambasadave të huaja, të akredituara në Tiranë, klerikë dhe besimtarë të shumtë.

Faqe 8-9

Tre takime në një ditë për "Viti i Naimit"

20 tetori 2020, ishte një ditë e ngarkuar me aktivitete, pjesë e programit vjetor të Kryegjyshitë Botërore Bektashiane për "Vitin e Naim Frashërit". Në këtë ditë, në orë të ndryshme të saj, ishin planifikuar dhe u zhvilluan tri aktivitete të rëndësishme, dy në Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës dhe tjetri në mjesdiset e Odeonit në Selinë e Kryegjyshitës ...

Faqe 11

Vizitë e Ambasadores amerikane, Yuri Kim, në teqenë e Zallit, Gjirokastrë

Vizita e Ambasadorit të Vatikanit në Shqipëri, Charles Johnes Brown, në Selinë e Shenjtë Bektashiane

Ambasadori i BE-së Luigi Soreca në Malin e Tomorrit

Faqe 18-19

Takimet me albanologun e njohur Robert Elsie dhe pengun për projektin e mbetur në mes

Eshkunë, 5 shtator 2020. Kolegu, publicisti dhe studiuesi i arkeologjisë, Nuri Çuni, teksa po bisedonim në kafe, më zgjat një kopje-projekt të librit të albanologut të njohur Robert Elsie, të përkthyer nga anglishtja e përgatitur për botim në shqip nga një shtëpi botuese...

Faqe 32

120 vjetori i kalimit nga jeta të Naim Frashërit në Selinë e Shenjtë Bektashiane

NAIMI YNË, bektashiu i ndritur



120 vjetori i kalimit nga jeta të Naim Frashërit, ka mbledhur në mjesdiset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, më 20 Tetor 2020, personalitete të ndryshëm letrarë, përfaqësues të feve në Shqipëri, përfaqësues të ambasadave të huaja, të akredituara në Tiranë, klerikë dhe besimtarë të shumtë.

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

11 N 141 (Tetor) 2020

11 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

10 N 141 (Tetor) 2020

Përkujtohet në Selinë e Shenjtë Bektash

Islami: Thirrje për një



Ferdinand Samarxhi , Mjeshër i Madh

Gjithë bota islame kremton këto ditë Profetin Muhamed, udhëheqësin shpirtëror të tyre. Si kudo dhe në Shqipëri po organizohen aktivitete kushtuar jetës, veprës, rrugës dhe misionit të Tij. Kryegjyshata Botërore Bektashiane së bashku me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, me pjesmarrje dhe të tarikateve të tjera Islame si dhe sekteve aleviane të Shqipërisë organizuan dje në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshitës Botërore, veprimtari

Shoqëria jonë njerëzore, e djeshmja dhe e sotmja, dëshmojnë se mësimet profetike, thëniet, qëndrimet dhe sidomos filozofia e Tij, mbeten gurë të rëndë themeli në godinën e fesë islame, e cila përveç ditëve të lavdishme dhe plot dritë të saj, ka pasur edhe stuhi gjithfarësh.

15 maj 2015 - Ditëlindja e Profetit Muhamed a.s.

Një familje të lumtur.

kushtuar ditëlindjes së Profetit Muhamed, Atij që zbriti si mëshirë për të gjithë, botët, profetin që përftoi si askush zemrat e gjithë njerëzve, atë që siç e ka quajtur Bernard Shou: “Lavdia më e madhe e kohërave që udhëhoqi njerëzimin në dritën e vërtetë”.

Përkujtojmë profetin që e shpalli fenë e Zotit, jo si shumë profetë të tjerë që ua shpallen fenë vetëm popujve të tyre, por për gjithë njerëzimin mbarë.

- Njeriun që triumfin, siç thotë Napoleon Bonoparti, fitoren e kurorëzoi me mëshirë dhe falje.

-Profetin që krijoi një religjion të cilin e pranuan, miliona e miliona njerëz dhe e shndërroi besimin në një fe universale. Kurrë njeriu si ka vënë vetes qëllim më të lartë si Profeti Muhamed, do të thosh Lamartini, poeti i madh francez i kohërave: “Të rrënojë besëtytnitë”.

-Në bazë të Kuranit Qerim: Në çdo garmë të tij, Ai ndërtoi nacionalizëm shpirtëror: urrejtje kundër zotave dhe besim te një Zot i Vetëm, të pamaterializuar. Ideja e një Zoti të Vetëm që predikoi bëri të mundur rrëzimin e gjithë tempujve të lashtë të idhujtarisë.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Bismilahi Rrahmani Rrahim!

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Shumë të nderuar vëllezër të mijë, përfaqësues të lartë të Komunitetit Mysliman në Shqipëri!

Të nderuar klerikë dhe besimtarë bektashianë!

Mevludi i sotëm, në ditën e bekuar të kujtimit të lindjes së Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi ‘Të, më jep rastin e shkëlqyer t’ju sjellë urimet e sinqerta të miliona besimtarëve bektashinjve në gjithë botën. Qofshi gjithmonë të lumtur dhe të ndriçuar në mirësitë e Profetit tonë!

Zoti i Lartë u plotësoftë çdo dëshirë që i shërben vëllazërimit!

Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi ‘Të, me jetën dhe veprën e tij, ka qenë dhe mbetet një model unik për

të gjithë brezat e besimtarëve myslimanë. Ai diti të transformojë veten, ndjekësit e tij dhe më pas gjithë shoqërinë arabe aq të prapambetur, vetëm e vetëm përmes sakrificave, durimit, dashurisë për dije, vendosmërisë për unitet dhe vëllazëri në fiset e përçara. Ai mundi të kultivojë në mendjet e njerëzve që përbënin familjen e madhe myslimane, mëshirën universale, larg luftërave dhe betejave të verbra për pasuri. Ai diti të dallojë gjërat kalimtare dhe të vdekshme të kësaj bote, për t’iu bashkuar të vërtetave të mundimshme, por të përjetshme.

Shoqëria jonë njerëzore, e djeshmja dhe e sotmja, dëshmojnë se mësimet profetike, thënie, qëndrimet dhe sidomos filozofia e Tij, mbeten gurë të rëndë themeli në godinën e fesë islame, e cila përveç ditëve të lavdishme dhe plot dritë të saj, ka pasur edhe stuhi gjithfarësh, të ardhura prej civilizimeve të tjerë. Por nëse kjo godinë u bëri ballë sizmikes së nëndheshme të këtyre civilizimeve, nëse ajo erdhi duke u rritur e zhvilluar, kjo ka të bëjë në mënyrë të veçantë me traditën profetike të dialogut, mirësisë, urtësisë dhe dashurisë vëllazërore. Në këtë këndvështrim, ne të gjithë mendojmë se jemi duke ecur në gjurmët e prijësit tonë largpamës.

Motra dhe vëllezër të mij!

Kur çdokush nga ne dëshmon dorëzimin tek Allahu Fuqplotë dhe kërkon të ngrihet në piedestalet e adhurimit tek Ai, detyra e parë që na kujtohet është pikërisht të ecim në rrugën e drejtë, në rrugën e mirësisë, të urtësisë, të besimit të palëkundur dhe veprave të mira. Prandaj në çdo rrahje të zemrës sonë, në çdo veprim që ndërmarrim, në çdo fjalë që nxjerrim prej buzëve, ne kemi kurdoherë nevojë për ndihmën dhe mëshirën e përjetshme të Krijuesit, prandaj thërrasim kurdoherë me mendje fjalën e urtë dhe të bukur të Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi ‘Të!

Kryefjala e çdo mendimi e çdo thënie tonën është: “Udhëzoni në rrugën e drejtë. Ajo është rruga e të



KRYEGJYSHI BOTËROR: Kur çdokush nga ne dëshmon dorëzimin tek Allahu Fuqplotë dhe kërkon të ngrihet në piedestalet e adhurimit tek Ai, detyra e parë që na kujtohet është pikërisht të ecim në rrugën e drejtë, në rrugën e mirësisë, të urtësisë, të besimit të palëkundur dhe veprave të mira. Prandaj në çdo rrahje të zemrës sonë, në çdo veprim që ndërmarrim, në çdo fjalë që nxjerrim prej buzëve, ne kemi kurdoherë nevojë për ndihmën dhe mëshirën e përhershme të Krijuesit, prandaj thërrasim kurdoherë me mendje fjalën e urtë dhe të bukur të Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi 'Të! Kryefjala e çdo mendimi e çdo thënie tonën është: "Udhëzoni në rrugën e drejtë. Ajo është rruga e të dërguarve, me të cilën Allahu i dritësoi ata!"

dërguarve, me të cilën Allahu i dritësoi ata!" Rruga e drejtë, padyshim, është e vështirë. Ajo nis me besën e dhënë myrshidit, me dorëzimin pa kushte, me flijimin e gjërave të përkohshme për hir të dashurisë së përhershme, me zbatimin e të gjitha detyrave të përcaktuara aq kthjellët në Kuranin Qerim. Ajo udhë ka qenë dhe do të mbetet udha e sakrificave të mëdha e të përhershme. Por ne nuk do të lodhemi kurrë së udhëtuari, sepse kemi një model të ndritur si Profeti ynë. Çdo përpjekje për të ironizuar Profetin tonë, aq më tepër çdo krim për gjoja mbrojtje të dinjitetit të Profetit, asnjëherë nuk kanë pasur dhe nuk do të kenë lidhje me fenë. Feja Ismale është thirrje për një familje të vetme dhe të lumtur.

Mbas Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, ishte Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Spahiu i cili tha:

Besimi se ekziston një fuqi e lartë e cila kontrollon universin e me këtë edhe ne, njeriut i jep një intuitë që ta shikojë këtë botë nga një prizëm krejtësisht tjetër. Shkatërrimi apo vdekja e çdo gjëje në natyrë, e bashkë me të edhe ringjallja e asaj që shkatërrohet, i jep njeriut një mësim se edhe ai është pjesë e natyrës dhe si i tillë do të pësojë ndryshimin fizik. Kuptimi dhe mendimi i thellë i kësaj e ndryshon njeriun, e bën atë më të dobishëm në atë që është e përhershme. Me kalimtarin e fiton të amshueshmen. E jeta e Muhamedit (a.s.) është shembulli më i mirë për realizimin e saj.

Ai zotëri jo vetëm që është nderuar, respektuar dhe është ndjekur rruga e tij profetike nga myslimanët në përgjithësi, por, siç dihet realisht, ai nderohet dhe vlerësohet edhe nga ithtarë të besimeve të ndryshme, të cilët i japin merita për të gjitha çështjet dhe respektohet me nderim nga dijetarë dhe shkencëtarë të mëdhenj, nga politikanë dhe filozofë të shquar, nga akademikë dhe letrarë të njohur të botës. Njëri ndër themeluesit ideologjik të Revolucionit Francez, filozofi Lafajet më 1789 para se të shpallejshin të famshmet "Të drejtat e njeriut", i kishte studiuar të gjitha sistemet juridike dhe, duke parë lartësinë e drejtësisë islame, kishte thënë:

"O Muhamed! Atë që ti ke sjellë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë në një vend të paarrtshëm...!"

Edukata morale dhe etike si dhe influenca shpirtërore e Muhamedit (a.s.) ishte aq e thellë dhe e fuqishme, sa që njerëzit të cilët ishin gjysmë të egër, larg civilizimit, arritën të jenë të butë, të mëshirshëm dhe të krijojnë një shoqëri të mrekullueshme e që sot historia e njerëzimit e shikon me lakmi dhe nuk njih një gjeneratë të tillë diku tjetër.

Ai është një njeri i dërguar për ta rishikuar konfiguracionin e tokës dhe për t'i hapur njerëzimit horizonte të reja duke u pajisur me një shpirt dhe kapacitete të posaçme, kështu që vlerësimi i tij i kapërcen kriteret tona. Duke u nisur nga kjo, kushdo që të përpiqet për të treguar për të, nuk do të mundet ashtu siç duhet. Ajo që kalon nga zemra në gjuhë është vetëm si një pikë në gjithësinë e pafund, sepse zemrat

dhe gjuhët janë të paafta për ta përshkruar Muhamedin a.s. Ai është njeriu i dimensioneve krejt të veçanta. Ajo çfarë neve na takon të bëjmë, është zelli për ta akorduar veten tonë në vijën dhe frekuencën e tij.

Jeta e Profetit Muhamed a.s është e jashtëzakonshme, vlerat më të larta të etikës e moralit janë të mbledhura tek ai. Rrethi i tij i edukimit përfshinte të gjitha shtresat e njerëzimit. Të gjithë popujt, gjuhët, ngjyrat, shtresat shoqërore, sociale dhe kulturore tuboheshin rreth tij. Nuk ka asnjë shënim në të cilin thuhet se dikush e ka pasur të ndaluar të gjendej në rrethin e tij. Rrethi i tij nuk i përkiste vetëm një populli, por i përngjiste një gostie ku njeriu vlerësohej vetëm si njeri pa kurrfarë dallimi tjetër.

Kush dëshiron ta përsosë moralin e Tij, le të marrë shembull prej natyrës dhe sjelljeve të shkëlqyera të Muhamedit (a.s.), i cili që prej 14 shekujsh e pasuroi njerëzimin me cilësitë më të larta të moralit. Ky njeri ofron rregulla të moralit të cilat shumë i mungojnë njeriut bashkëkohor, i cili, duke ndjekur dhe duke imituar lloje të ndryshme të etikës, është zhveshur nga normat humane. Në një thënie të tij thotë: “Butësia dhe mirësjellja e cila nuk duket shumë e rëndësishme në këtë botë, nesër në Ditën e Gjykimit do të ketë rëndësi shumë të madhe”.

Siç shihet dërgimi i Muhamedit (a.s.) është mëshirë nga Zoti i madhëruar që njerëzit t’i zgjidhin problemet e tyre në mënyrë të drejtë dhe humane, sepse Ai që na krijoi më së miri i di nevojat e krijesave, prandaj përmes Kuranit dhe traditës profetike ofron udhëzime afatgjatë dhe të përsosura.

Pejgamberi (a.s.) me moralin e tij të lartë që ia kishte dhuruar Allahu i Lartësuar, i vlerësonte të gjithë njerëzit pa marrë parasysh se cilës feje i përkisnin. Ja një shembull pse njerëzit duhen të krenohen me këtë Profet. Një ditë tek po qëndronte me një shok të tij pranë rrugës, aty kalon një xhenaze hebreu dhe ai menjëherë ngrihet në këmbë në shenjë respekti. Shoku i tij i thotë: “O i dërguari i Allahut! Ai ishte një hebre”, ndërsa Resulullahu (a.s.) pa u zemëruar fare iu përgjigj: “Pse, a nuk është njeri me shpirt edhe ai?” Pra, mbi të gjitha, është njeri dhe kësaj thënieje nuk mund t’i shtojmë asgjë tjetër. Nëse ne jemi ndjekësit e Krenarisë së Njerëzimit, të kësaj thënieje, nuk kemi se si të mendojmë ndryshe nga ai. Nga kjo thënie dhe sjellje e mirë e Profetit (a.s.), kuptojmë se njeriun ngase është njeri duhet ta duam dhe ta respektojmë, sepse kjo tregon respektin ndaj Krijuesit. Përndryshe nuk do të ishte dashuri dhe respekt i sinqertë.

Parim kryesor në kulturën tonë është: të duash krijesat për hir të Krijuesit. Sepse Allahu e krijoi gjithësinë me dashuri. Dashuria është shkaku dhe thelbi i ekzistencës si dhe është lidhja më e fortë për bashkimin dhe marrëdhënien e krijesave njëra me tjetrën. Çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi është një art i Allahut Fuqiplotë. Nga ky këndvështrim, nëse ne nuk i duam njerëzit që janë



KRYETARI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË Z. SPAHIU:

Besimi se ekziston një fuqi e lartë e cila kontrollon universin e me këtë edhe ne, njeriut i jep një intuitë që ta shikojë këtë botë nga një prizëm krejtësisht tjetër. Shkatërrimi apo vdekja e çdo gjëje në natyrë, e bashkë me të edhe ringjallja e asaj që shkatërrohet, i jep njeriut një mësim se edhe ai është pjesë e natyrës dhe si i tillë do të pësojë ndryshimin fizik. Kuptimi dhe mendimi i thellë i kësaj e ndryshon njeriun, e bën atë më të dobishëm në atë që është e përhershme. Me kalimtarin e fiton të amshueshmen. E jeta e Muhamedit (a.s.) është shembulli më i mirë për realizimin e saj.

një art i Allahut, atëherë kemi zemëruar Zotin, ata që i do Ai dhe ata që e duan Atë. Nga kjo pikëpamje, jo vetëm njerëzit, kafshët dhe krijesat duhet t'i duam. Përbuzja dhe nënvlerësimi i tyre do të thotë nënvlerësim i Krijuesit të tyre. Mënyra e sjelljes me njerëzit mbështetet në parimin: t'i duam krijesat për hir të Krijuesit.

Një besimtar, duke filluar nga të afërmit dhe më gjerë, duhet të përhapë dritën e dashurisë, miqësisë dhe të dialogut. Çdo mysliman përballë krijesave të tjera, duhet ta mbushë zemrën e tij me ndjenjën e mëshirës për hir të Krijuesit.

Allahu e dërgoi Profetin Musa a.s tek Faraoni dhe i tha: "Thuaji fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet". Nga ky ajet kuptohet që megjithëse Faraoni e kishte luftuar Musain dhe popullin e tij, ai duhet t'i fliste me një gjuhë të ëmbël dhe me fjalë të buta dhe prekëse. Sepse qëllimi nuk është të hakmerresh, por t'i ftosh njerëzit drejt së vërtetës dhe shpëtimit. Në këtë ajet, pikë kryesore është: "Kaulun Lejinun" pra, fjala e butë. Atëherë personit që është përballë teje cilido qoftë ai, nëse dëshiron t'i shpjegosh diçka, është kusht që t'i flasësh butë dhe të tregohesh tolerant ndaj tij. Përsëri Allahu në Kuran thotë:

"Të keqen ktheje me të mirë, sepse atëherë ai me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt".

Poshtë këtij titulli shkurtimisht mund të themi që në Islam, bazë kryesore është falja dhe toleranca, sepse Resulullahu (a.s.) thotë: "Bëhu tolerant që të tolerohesh". Përfundimisht mund të themi se as në Islam, as tek Pejgamberi (a.s.) nuk ekziston urrejtja dhe mëria por dashuria, toleranca dhe durimi janë cilësitë dhe çelësat që hapin çdo derë. Nuk ka dyshim se tek ata që gjenden këto cilësi, nëse sot jo, nesër patjetër do t'i fitojnë të gjitha zemrat.


Kur e pyetën nënën e besimtarëve, Aishen r.a se cili ishte morali i Profetit a.s, ajo u ishte përgjigjur: "Moral i Profetit ishte Kur'ani". Profeti a.s është një shembull i bukur me sjelljet dhe personalitetin e tij të lartë. Në fakt Kur'ani e shfaq Profetin a.s si të vetmin që duhet të merret shembull, ku thote: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun".

Më pas u zhvillua ceremonia fetare e mevludit me pjesëmarrjen e personaliteteve fetare si dhe besimtarëve bektashianë.



120 vjetori i kalimit nga jeta të Naim Frashërit, në Selinë e Shenjtë Bektashiane

NAIMI YNË, bektashiu i ndritur



ubileu i 120 vjetorit të kalimit nga jeta të Naim Frashërit, ka mbledhur në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, më 20 Tetor 2020, personalitete të ndryshëm letrarë, përfaqësues të feve në Shqipëri, përfaqësues të ambasadave të huaja, të akredituara në Tiranë, klerikë dhe besimtarë të shumtë. Aktiviteti përkujtimor nisi me himin tonë kombëtar dhe më tej ishte Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj i cili duke falënderuar të pranishmit shtoi midis të tjerave:

“Kam privilegjin dhe kënaqësinë e veçantë t’ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë event dhe dua t’ju uroj e bekoj, ju dhe familjet tuaja: “Paçi kurdoherë pranë ndihmën e Zotit, të dymbëdhjetë imamëve, të Pirit tonë, Haxhi Bektash Veliut! Drita e tyre na ndriçoftë rrugën tonë!”

Siç shumë të jeni në dijeni, këtë vit, shpallëm Vitin e Naimit të madh, jo thjeshtë për ta kujtuar atë, por për të hedhur dritë akoma më shumë rreth jetës dhe veprës së tij të madhe, të bindur se këto kohë kanë qenë të lidhura ngushtë me fatet e kombit tonë. Sepse mendoj se përpara se të ishte poet i madh, ai ishte shqiptar i madh. Ishte thjeshtë shqiptar jo vetëm nga gjeneza familjare, por nga dashuria që përcillte për viset amtare,

ndonëse jeta e tij në pjesën më të madhe, kaloi në dherra të huaj. Brezat e shqiptarëve, qysh në fund të shekullit të 19-të, të 20-të dhe të këtij mileniumi që po jetojmë, kanë mësuar dhe janë lëvdur me vargjet e fuqishëm:

Ti Shqipëri më jep Nderë,

Më jep emrin shqipëtar...

Dhe nëse në shekujt e kaluar këta vargje mbajtën gjallë krenarinë e ligjshme të prejardhjes sonë biologjike, frymëzuan identitetin tonë kombëtar, në kushtet e sotme ato tingëllojnë aspak të vjetruara, të dalë kohe. Me qindra mijëra shqiptarë të sotëm, të atyre që jetojnë e punojnë në dyert e Europës, të atyre që japin kontributin në këtë Shqipëri që kemi sot, i përsërisin ende me shpresë këto vargje, të bindur se mëmëdheu i tyre, nuk do të fyhet pafund, nuk do të jetë delja e zezë e qytetërimit, nuk do të jetë varfanjakja e Europës. Përkundrazi, ne kemi shpresë që me ndihmën e të Madhit Zot dhe me vullnetin tonë, të ecim përpara, duke e përmendur me respektin më të thellë emrin e Shqipërisë. Naimi ynë ka qenë dhe padyshim mbetet një bektashi i ndritur. Ai ka parë tek ky tarikati i Islamit, devocionin e thellë ndaj Krijuesit, frymën e tij atdhetare dhe sidomos shenjtërinë për t’u bashkuar të gjithë në të mirë të kombit. Ndër të parët mendimtarë të Rilindjes tonë Kombëtare, duke parë tolerancën bektashiane, ai bëri thirrje që këtij besimi t’i jepej vendi i merituar në jetën e krejt shqiptarëve. Jo pa qëllim, ne menduam të sjellim në këtë auditor të nderuar, idetë e disa poetëve dhe njerëzve të shquar të letrave të sotme shqipe, të cilat do të shpalosin universin letrar të Naim Frashërit dhe në mënyrë të veçantë qasjet e tij në rrafsh të bektashizmit”.

Ishte studiuesi Bardhyl Londo, i cili në fjalën e tij, u ndal në një nga poezitë epike të Naimit, Abaz Aliu, e cila sipas tij mbetet kryevepra e këtij poeti. Më tej Londo tha: Padyshim Abaz Aliu në vargje mbetet një kryevepër Naimjane. Dhe është e çuditshme se në perla të tilla poetët e mëdhenj shfaqen jo vetëm të realizuar plotësisht, por mbi të gjitha, ata shfaqen edhe të tjetërsuar, në kuptimin që e kalojnë veten, mohojnë ose më saktë shpërthejnë kornizat e sistemit të tyre filozofik, kapërcejnë kufij kohorë duke sulmuar ardhmërinë, mohojnë kohën për të qenë profetët e së ardhmes, madje sfidojnë bashkëkohësin për t’u bërë qytetarë të të gjitha kohërave. E komentuar në ambiente të caktuara, kjo poezi tek shumë shqiptarë ka rikrijuar artistikisht

një ambient gati ireal dhe është barazuar me shfaqjen e Zotit. Për fatin tone të keq, kjo vjershë deri vonë s' ishte botuar në Tiranë. Kështu që një brez i gjithë, duke filluar nga 50-60 vjeçarët e poshtë, ende s' e njohin atë. Injoranca dhe brutaliteti komunist, ashtu si me gjithë kulturën e letërsinë, u sollën barbarisht edhe me Naimin e madh. Është naive të mendosh, se bilbilin e Frashërit diktatura komuniste e përkrahu, ndonëse i festonte përvjetorët, ndonëse e quante poet kombëtar: Jo, ajo e shfrytëzonte për qëllimet e veta apostullin e shqiptarizmit dhe kjo, pa dyshim, është një nga fyerjet më të mëdha që i është bërë Naimit dhe kulturës sonë kombëtare. Mjafton të kujtojmë për këtë se deri vonë dy të tretat e veprës naimiane s' ishin botuar ende në Tiranë si të papërshtatshme nga ana ideologjike.

...Por, le të rikthehemi tek "Abaz Aliu" dhe tek mendimi se Naimi sa është krijues i harmonisë, aq është dhe shpërthyes i saj për të krijuar një harmoni të re, sa është shpallës i sistemeve të sakta e të kalkuluara, ashtu është edhe prishës i tyre, për të krijuar sisteme të reja po aq të sakta. "Abaz Aliu" është një subjekt i pastër fetar, po a është vjersha e tillë? Do të bënim gabim të mendonim ndryshe, sepse Naimi nga historia e Hysenit dhe Fatimes nuk ka ndryshuar asgjë. Kështu, pra, ai kërkon dhe gjen harmoninë e pranuar nga të gjithë. Por, çuditërisht ai e shkel këtë harmoni, po aq me vendosmëri sa e ka gjetur dhe krijuar atë. Vini re vargjet:

Me ç'do an'i ka rrethuar/ Kombi faqezi

Komb'i lik i mallëkuar / Porsi mizëri

...Kështu, pra, duke i mbetur besnik deri në imtësi historisë së Hysenit dhe Fatimes sipas fesë, papritur Naimi krijon një harmoni krejt të re, që është po aq e besueshme dhe jeton në harmoni me të parën. "Të përiqemi ditë e natë për atë komb, që i quan Atë e përgjeronet për ata, të punojnë bashkë me parësinë e me pleqësinë për shpëtim të Shqipërisë e të shqiptarit, për diturit e për qytetarët të Kombit e te Mëmëdheut të tyre, për gjuhën e vet dhe për gjithë mbrothësitë e mbarësitë etj." Pasi është endur, pra në historinë dhe botën bektashiane, papritur Naimi shkëputet prej tyre dhe na kujton se vendi i bektashinjve qenka Shqipëria, sepse ata paskan një komb që quhet shqiptar. A duhet konsideruar kjo naivitet apo një instrument thjesht i lindur nga ndjenjat patriotike? Ndërsa i pari mohohet kategorikisht, i dyti shpreh një pjesë të së vërtetës, por jo gjithçka.

Kodi bektashian kthehet, pra, në një kod etiko-moral të vetë shqiptarëve. E njëjta gjë ndodh edhe me vjershën e Abaz Aliut. Pas vdekjes tragjike të Hysenit dhe Fatimesë, ndodhi:

Abaz Aliu zu Tomorre / Erdhi afër nesh,

Shqipëria s' mbet e gjerë, / Se Zoti e desh,

Kështu pra, nëse Noli konstaton për Khajamin se ai është aq i madh sa s' mund ta fusësh në ndonjë nymë të caktuar letrare, unë do të thosha se Naimi është aq i madh sa nuk e nxë asnjë përkufizim sado i saktë e dashamirës të jetë.

Paskëtaj, ishte shkrimtari i njohur Besnik Mustafaj, i cili duke u ndalur në shqiptarizmin e Naim Frashëri, vijoi: "Lidhur me fatin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, Naim Frashëri ka bërë me poezi atë që i vëllai, Samiu, ka bërë me prozën e tij filozofike dhe politike. Siç e tregon fare qartë historiografia, ky zgjim ishte jetik për ekzistencën e mëtejshme të kombit shqiptar. Do mbajtur parasysh se jemi në çerekun e fundit të shekullit XIX. Të gjithë fqinjët tanë kishin fituar tashmë pavarësinë dhe, pasi kishin hedhur themelet e shteteve të tyre, po kalonin në një fazë të rritjes duke synuar zgjerimin e territorit.

Gjithsesi, një fakt i tillë historik nuk ka asnjë rëndësi tashmë. Dhe as nuk është rasti të ndalemi te strategjitë politike të Sulltan Abdyl Hamitit dhe të kabineteve të tij qeveritare. Për ne sot më duket me vlerë të vemë në pah kthjelltësinë e jashtëzakonshme të Naim Frashërit për t'i lexuar me realizëm zhvillimet e dukshme dhe ato të nëndheshmet brenda Perandorisë Osmane dhe më gjerë, lidhur gjithnjë me udhëkryqin, ku gjendej kombi shqiptar. Naim Frashëri jetonte në Stamboll, ku edhe po ndertonte veprën e tij poetike. Ai nuk i qasej këtij realiteti

gjeopolitik i nxitur nga ndonjë kureshtje intelektuale, siç ndodhte shpesh me poetët e nivelit të tij në metropolet e tjera europiane.

Gjithë vepra e tij me temën kombëtare thekson urgjencën për t'u përballur me kurajo dhe besim në vete kohë me këto rreziqe. Pra, ai e ka kuptuar shumë drejt se vetëm shqiptarët mund t'i dilnin zot vetes dhe atdheut të tyre.

Naim Frashëri do të vinte gjithë imagjinatën e vet dhe e gjuhës poetike në shërbim të një kauze të tillë, e cila, par definition është kauza e politikanëve. A ishte kjo një lloj tradhtie ndaj poezisë së simboliste, që ishte më modernia e kohës në Evropë dhe të cilës do t'i kishte përkritur vepra e tij ashtu siç pati filluar?

Naim Frashëri me jetën e tij, të mishëruar madhërisht te kjo pjesë e veprës së tij, është bërë frymëzim për poetët e tjerë besoj si asnjë poet tjetër në mbarë historinë e letërsisë botërore. Dhe kjo ka filluar qysh në të gjallë të tij, ka arritur kulmin 120 vjet më parë, kur ai mbylli sytë dhe ka vazhduar e vazhdon deri në ditët tona. Në biblioteklën shqiptare është një botim që meriton të kujtohet me respekt me këtë rast: 155 poetë në 150 vjetorin e lindjes së Naimit. Është përgatitur nga Mehmet Gëzhilli dhe botuar 24 vjet më parë. Aty gjejmë përkushtimet e Koto Hoxhit e të Lef Nosit, të Filip Shirokës e të Mihal Gramenos, të Shtefën Gjeçovit e të Asdrenit, të Çajupit e të Josif Bagërit, të Lasgush Poradecit e të Sejfulla Malëshovës, të Petro Markos e të Perlat Rexhepit, të Dritëro Agollit e të Dhimitër Shuteriqit, të Ismail Kadaresë e të Bardhyl Londos, të Xhevahir Spahiut e të Skënder Buçpapajt, të Sabri Hamitit e të Petrit Rukës. Asnjë hero i historisë tonë, përgjash-tuar Skënderbeu, nuk ka kaq shumë përkushtime. Ma merr mendja se Naim Frashëri, ndryshe nga i vëllai, Avdyli, nuk ka zbratur kurrë në jetën e tij një pushkë. Ai është ngjitur në pedestalin e heroit kombëtar vetëm përmes penës.

Kumtesa e fundit e këtij aktiviteti kishte të bënte me aspektin simpolik të poemës së famshme "Qerbelaja". Ishte studiuesi i njohur, Prof. Sadik Bejko, i cili lidhur me këtë epos Naimjan tha midis të tjerave: "Qerbelaja", veper e Naim Frashërit, botuar në Bukuresht më 1889, është një poemë epike me subjekt nga historia e Kalifatit arab. Poema shtjellon ngjarje që ndodhin në shekullin e IX-XV. Ngjarjet kryesore zhvillohen në luginën e Qerbelasë, në Irak. Në tetor të vitit 680 nipi i Profetit Muhamed, Imam Huseni, u vra bashkë me 72 meshkuj luftëtarë të Familjes së Profetit, ndërsa femrat e tyre, të mbetura gjallë, u robëruan dhe u keqtrajtuuan nga ushtria e Jezidit, kundërshtarit fitimtar.

Si temë e zymtë dhe e madhërishtme, kjo do t'i shkante përshtat talentit të një poeti siç ishte Naim Frashëri, poet i dimensioneve tragjike dhe universale. Me ardhjen si kalif i kësaj perandorie të imam Aliut, dhëndrit të Muhamedit, kalif që sundoi nga viti 665 deri më 661, filloi lufta civile, përlëshja me armë me Mavijen, guvernatorin e Sirisë, pinjollin nga familja e rëndësishme e Umajadëve. Nga kjo luftë për pushtet Aliu mbetet i vrarë. Nga ana tjetër, kjo periudhë do të shoqërohej me revoltat e kundërshtarëve të Umajadëve, të cilët ishin përqendruar në Iran, Irak etj. Familja e Aliut e mëtonte trashëgiminë e kalifatit si zgjedhje të dhënë nga ana e Zotit dhe e Profetit Muhamed. Meqë kjo nuk ndodhi, plasën luftërat shekullore për pushtet, luftëra për kryesimin e kalifatit. Këtu e merr lëndën poema e Naim Frashërit.

Përtej lëvizhës historike të luftërave civile për pushtet, realiteti i miliona viktimave të dhunës çnjerëzore, flijimi i të pafajshmëve, i të pafuqshmëve, i të pambrojturve, u dhanë ngjarjeve të Qerbelasë një përmbajtje të lartë ideologjike, përmbajtje fetare, frymëzim hyjnor të luftës mes të mirës dhe të së keqesë, të luftës mes Zotit dhe djallit, pra, u gatua një lëndë e së madhërishtme, e tragjike, lëndë që ushqeu dhe ushqen ndarjet përcarëse fetare të përmasave të tilla që vazhdojnë edhe sot.

Ai ishte poeti misionar i popullit të vet. Ishte mësuesi, ideologu kombëtar. . . Mbase është koha të themi dhe diçka tjetër. Poeti është poet. Si poet me talent ai i shpërthen kufinjët, del jashtë kohës dhe jashtë vendit të vet. Bëhet qytetar i botës.

Tre takime në një ditë për “Viti i Naimit”

20 tetori 2020, ishte një ditë e ngarkuar me aktivitete, pjesë e programit vjetor të Kryegjyshit Botërore Bektashiane për “Vitin e Naim Frashërit”. Në këtë ditë, në orë të ndryshme të saj, ishin planifikuar dhe u zhvilluan tri aktivitete të rëndësishme, dy në Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës dhe tjetri në mjediset e odeonit, në Selinë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, po në Tiranë. Aktivitetet e kësaj dite ishin: Ekspozita “Ti Shqipëri më jep nder”; promovimi i librit të sudjuesit të njohur kosovar Sabri Hamitit, me titull: “Naim Frashëri” dhe aktiviteti “Vlerësime dhe mesazhe të veprës së shkruar të Naim Frashërit”.

Ekspozita fotografike në Muzeun Historik Kombëtar

Aktiviteti i parë i kësaj dite, që përkon me 120-vjetorin e vdekjes së Naim Frashërit ishte ceremonia e çeljes së ekspozitës “Ti Shqipëri më jep nder”, e cila u realizua në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Ky aktivitet u përgatit nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, në bashkëpunim



me Muzeun Historik Kombëtar. Në këtë ceremoni, krahas artistëve, shkrimtarëve, personaliteteve të artit e kulturës, deputetë e funksionarë shtetërorë, merrnin pjesë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, studjues të ndryshëm, diplomatë etj...

Organizatorët, në çelje të aktivitetit, pasi falënderuan pjesëmarrësit, miqtë dhe të ftuarit, piktorë, skulptorë e studjues që kontribuan në përgatitjen e kësaj ekspozite, theksuan se përkujtimi me aktivitete të shumta të “Vitet të Naim Frashërit”, shpallur e organizuar nga Selia e Shenjtë Botërore Bektashiane, është një tjetër vlerësim i madh për evidentimin e njohjen sa më të thellë të asaj që “ky poet i madh kombëtar ka dhënë për Shqipërinë, shqiptarët e kombin shqiptar, për historinë, kulturën, gjuhën shqipe e bektashizmin...”. Sipas tyre, “librat, fotografitë, reliket e sendet e tjera të afishuara në këtë ekspozitë, janë jo vetëm një vlerësim brezash, një vlerësim shtetëror e qytetar për jetën e veprën e Naim

Frashërit, por dhe një ndihmesë e çmuar për brezat e sotëm për këtë poet e atdhetar”.

Në vazhdim, personalitete të pranishëm, përshëndetën këtë aktivitet me vlera.

Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror Bektashian : “...Hapja e kësaj ekspozite, titulluar “Ti Shqipëri më jep nder”, si pjesë e aktiviteteve të shumta të “Vitet të Naim Frashërit” që ne kemi shpallur si Seli e Shenjtë, është organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Muzeut Historik Kombëtar, të cilët unë i falënderoj nga zemra, i bekoj dhe uroj shëndet, paqe, mirësi e dashuri në familjet e tyre dhe shoqëri. Sigurisht, kjo ekspozitë që ne po çelim sot, në ditën e 120 vjetorit të lindjes së bektashiut të madh, poetit kombëtar Naim Frashëri, ashtu si dhe aktivitetet e tjera që kemi bërë dhe do të bëjmë në harkun e 12 muajve, nuk janë të lehta, kanë mund e vështirësi. Por me përkushtimin tonë, mbështetjen që nuk na ka munguar nga gjithë faktorët e komunitetit, me ndihmën e Zotit, ja kemi arritur dhe do ja arrijmë. ...Kjo është një punë, që ne do t’ia japim rinisë sonë të dashur, e cila edhe ajo bashkë me ne, do të luftojë për të përballuar vështirësitë, që të mbajmë këtë komb që i ka dhënë botës dhe njerëzimit, që edhe ne të bëhemi një popull i civilizuar për t’u futur në Europë, si të gjithë popujt e tjerë...!”

Dorian Koçi (Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, studjues): “Këtë vit ne do të dëshironim që të thoshim ‘120 vjet me Naim Frashërin’, pasi Naim Frashëri në mendimin kulturor, politik shqiptar nuk ka vdekur asnjëherë, ende vazhdon që të frymojë frymën e shqiptarizmit...!”

Akademik Sabri Hamiti: “... Për Naim Frashërin është folur, shkruar, janë hapur e do të hapen ekspozita, pasui ai e vëllezërit e tij, kanë bërë shumë për kombin shqiptar, në një periudhë etjet të vështirë. A ka format të vëllezërve Frashëri që implikohen në politikë? Tani jemi në dy kohë. Shqiptarët vështirë e kapur diskursin në kohë të Samiut, i ka pushtuar ndjesia e Naimit. Nëse i shohim këto tre elementë, që kemi në këto tre figura të një familjeje, që rrallë ndodh, pak si vështirë është që të shikojmë njeriun sot në këto tre dimensione. A janë të vlefshëm dijetarët, njerëzit e shpirtit, për zhvillimet politike? -Po. A janë aty? -Jo...”.

Ambasador i Francës në Shqipëri: Jam i emocionuar që jam sot në teljen e ekspozitës, kushtuar poetit tuaj kombëtar Naim

Frashëri, njëkohësisht dhe intelektualit me përmasa të gjera që si atdhetar, ka bërë shumë për historinë, kulturën e gjuhën tuaj. Personalitete të tillë që kanë lënë gjurmë në histori, kur vlerësohen ndër breza, bëhen më me vlerë për shoqërinë, pasi janë dhe pikë orientimi për të ecur në të ardhmen...!”

...Vizitorë të shumtë panë nga afër materialet e ekspozitës, e cila do të qëndroj e hapur për 10 ditë, vlerësuan punën e përgatitës të kësaj ekspozite, Mehmet Gëzhillin dhe, një pjesë e tyre lanë përshtypje dhe në librin e vënë për këtë qëllim.

Akademiku Sabri Hamiti promovon veprën “Naim Frashëri”

Më 20 tetor 2020, në kuadër të “Viti i Naim Frashërit”, u promovua në Muzeun Historik Kombëtar libri më i ri i akademik Sabri Hamitit, “Naim Frashëri”. Ky libër i botuar nga shtëpia botuese ALBAS, është një punim monografik kushtuar romantikut të madh shqiptar me rastin e 120-vjetorit të shkuarjes së tij në amshim. Libri është botuar nga shtëpia botuese ALBAS. Në 170 faqe të tij, thuret profili i shkrimtarit të dashur e të adhuruar të letërsisë shqipe, i cili kishte arritur statusin e pakontestueshëm të poetit kombëtar, por që për vite kishte qenë edhe i censuruar. Promovimi, u bë në mjediset (hollin) e jashtëm të Muzeut Historik Kombëtar.

Në fillim, prezantimin e librit e bëri Prof. Dr. Persida Asllani, Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, që është dhe redaktor e librit. Ndër të tjera, zj. Asllani pohoi: “...Libri që i kushtohet sot Naim Frashërit nga Sabri Hamiti shpalos leximin e pandërprerë të kësaj gjuhe të zjarrtë, lexim i dashurimit me të, qysh në vargun e parë, pa e zbehur personalen e thellë që endet aty. Sepse për Naimin mund të shkruhet tashmë vetëm kështu, i djegur nga gjuha e zjarrtë, i zhytur në hinin e vetvetes, përmes ndjeshmërisë së poetit, dashurisë së lexuesit dhe mjeshtërisë së studiuesit. Prandaj librin “Naim Frashëri” të Sabri Hamitit dua ta quaj një Naim jete. Është një Naim që dëshmohet ngadalë, për të gjithë, si një mrekullim i parë me letërsinë kombëtare, si një zbulim i hershëm i lirikës për dashurinë e bukurinë, si rigjetje e vijueshme e mistikës së besimit dhe etikës së lartë të qenies përmes mirësisë dhe përlulësisë. Është një Naim jete, me një lexim të gjatë e ngulmues, shtresëzuar nga përvojat e thella të jetës, nga përvojat edhe më të thella të letërsisë, nga metodologjitë studimore e kritikët e subjektivizuar e sidomos nga një përsosje e pashoqe ndër vite e shkrimit për poetin e poezinë, si finaliteti fundor i çdo shkrimi për letërsinë. Për plotërinë e këtij leximi, autori ka ndërmarrë edhe shqyrtimin e Naimit të të tjerëve, atyre që si ai, pararendës leximesh e dashurish për poetin, panënë veprën e tij thelbe të patjetërsueshme që i kthehen vazhdimisht dijes, vetëdijes dhe

ndjeshmërisë kombëtare. Merren në shqyrtim biografite dhe dëshmitë e Mid’hat Frashërit, intuimet e pasionet naimiane të Faik Konicës, sintezat mbresëlënëse të Çabejt, hetimet psikanalitike të Krist Malokit, analizat kulturologjike të Koliqit dhe leximet metafizike të Eqrem Kryeziut.

Autori i librit “Naim Frashëri”, akademiku Sabri Hamiti, në fund, përshëndeti të pranishmit pjesëmarrës në këtë promovim, duke theksuar indicien për këtë libër, kohën e gjatë që i ka marr ky studim dhe vlerësimet për poezinë e Naimit. Ndër të tjera ai tha: “Ju falënderoj të gjithëve sot për pjesëmarrjen dhe mendimet që dhatë...Jam

i lumtur që ky promovim përkon me 120 vjetorin e shkuarjes në amshim të poetit të madh kombëtar Naim Frashëri. Më ajnë dashur vite studim për të ardhur deri këtu. ... Poezia e Naimit, ka vlera të jashtëzakonshme... Poezia e Naimit është gjuha shqipe e shpirtëruar me pamje të dashurisë. Shqipja e tij e shkruar mbërriti statusin e gjuhës së komunikimit kombëtar. Shqipja e shkruar poetike, është e ndryshme, e dallueshme para tij e pas tij. Niveli i lartë i përjetimit krijoi fjalët e reja shqipe, që për breza të mëvonshëm morën statusin e përhershëm të gjuhës së nënës, gjuhës amtare. Si gjuhë e shpirtit, shqipja e Naimit u shenjtërua si pamje vokale e hyjit në trajtën e njeriut. Naimi, nuk synoi finalitete, i mjaftoi frymëzimi, që nuk njeh kohët, shpesh gënjeshtare, porse e pa frymëzimin burim të përjetshëm të njerëzisë. Duke e parë Hyjin (Perëndinë) jo vetëm në trajtën e njeriut, por në formën e gjësë së gjallë në natyrë, fjala e tij u bë mësim për vëllazërimin e mirësinë si postulate të harmonisë tokësore e divine. Qiriri që shkruhet, duke nxjerrë dritën njerëzore është prova e zgjimit për të kapur dritën e përjetshme që ndricon sferat. Naimi i këndon shqipes këngën e mahnitjes dashurore në trajtën e ninullës, që ka njomësinë e këngës së djepit, me timbrin e zërit të nënës. Edhe pse me Naimin na ndan një shekull, gjuha e poezisë së tij mbetet frymëzim edhe sot, si dikur...”.




Historianë dhe studjues për Naim Frashërin

Në mesditë të 20 tetorit 2020, në mjediset e Odeonit të Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, në kuadër të përvjetorit të 120-të të ndarjes nga jeta të poetit kombëtar Naim Frashëri, u zhvillua një takim i zgjeruar me studjues e historianë, kushtuar jetës dhe veprës së pavdekshme të këtij atdhetari. Në këtë aktvitet morën pjesë përveçse përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, shkrimtarë dhe dashamirës të letërsisë dhe arsimit shqip. Edhe ky event, ishte



pjesë e aktiviteteve të hartuara në kuadër të "Vitet të Naimit". Takimi u çel nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili përshëndeti të pranishmit, duke evokuar ndërkohë dhe rëndësinë e këtyre aktiviteteve. Ndër të tjera, Dede Edmond Brahimaj tha: Siç mund të jeni në dijeni, këtë vit, shpallëm Vitin e Naimit të madh, jo thjeshtë për ta kujtuar



atë, por për të hedhur dritë akoma më shumë rreth jetës dhe veprës së tij të madhe, të bindur se këto kohë kanë qenë të lidhura ngushtë me fatet e kombit tonë. Sepse mendoj se përpara se të ishte poet i madh, ai ishte shqiptar i madh. Ishte thjeshtë shqiptar jo vetëm nga gjeneza familjare, por nga dashuria që përcillte për viset amtare, ndonëse jeta e tij në pjesën më të madhe, kaloi në dhera të huaj. Brezat e shqiptarëve, qysh në fund të shekullit të 19-të, të 20-të dhe të këtij mileniumi që po jetojmë, kanë mësuar dhe janë lënduar me vargjet e fuqishëm:

Ti Shqipëri më jep Nderë, / Më jep emrin shqiptar... Dhe nëse në shekujt e kaluar këta vargje mbajtën gjallë krenarinë e ligjshme të prejardhjes sonë biologjike, frymëzuan identitetin tonë kombëtar, në kushtet e sotme ato tingëllojnë aspak të vjetruara, të dalë kohe. Me qindra mijëra shqiptarë të sotëm, të atyre që jetojnë e punojnë në dyert e Europës, të atyre që japin kontributin në këtë Shqipëri që kemi sot, i përsërisin ende me shpresë këto vargje, të bindur se mëmëdheu i tyre, nuk do të fyhet pafund, nuk do të jetë delja e zezë e qytetërimit, nuk do të jetë varfanjakja e Europës. Përkundrazi, ne kemi shpresë që me ndihmën e të Madhit Zot dhe me vullnetin tonë, të ecim përpara, duke e përmendur me respektin më të thellë emrin e Shqipërisë.

Në vazhdim, poeti Bardhyl Londo mbajti kumtesën 'Naim Frashëri. Regjimi komunist, u soll barbarisht me 'të!', ku ndër të tjera pohoi: "Ka krijime të veçanta të poetëve të mëdhenj që shërbejnë si një lloj pasaporte identifikimi për ta. Në krijime të tilla talenti i tyre arrin një shkallë të tillë koncentrimi dhe intensiteti shprehjeje, sa bëhet vetja e tyre e dytë. Dhe është e çuditshme se në perla të tilla poetët e mëdhenj shfaqen jo vetëm të realizuar plotësisht, por mbi të gjitha, ata shfaqen edhe të tjetërsuar, në kuptimin që e kalojnë veten, mohojnë ose më saktë shpërthejnë kornizat e sistemit të tyre filozofik, kapërcejnë kufij kohorë duke sulmuar ardhmërinë, mohojnë kohën për të qenë profetët e së ardhmes, madje sfidojnë bashkëkohësin për t'u bërë qytetarë të të gjitha kohërave. Një vjershë e tillë në krijimtarinë e Naimit të madh, midis 4-5 të tjerave, më duket se është "Abaz Aliu", ose më saktë rreth dy të tretat e kësaj vjershe. Jo rastësisht tek një brez i

vjetër shqiptarësh, kjo vjershë ka një fuqi hipnotizuese. E recituar në ambiente të caktuara, ajo te shumë shqiptarë ka rikrijuar artistikisht një ambient gati ireal dhe është barazuar me shfaqjen e Zotit. Me atmosferën e vet mistiko-hyjnore, me vizionin e saj të çuditshëm ku plekset në një trup të vetëm qiellorja dhe tokësorja, realja dhe mistikja, shpirtërorja dhe mate-

rialja, me ritmin e përkryer gati-gati të kulluar deri në shkallën që pretendon alkimia, me shqipen e saj të pashoqe ndoshta edhe deri në letërsinë e sotme (në rast se për krijimet e Naimit do të thoshim kanë gjuhë perëndie, për këtë vjershë mund të themi ka gjuhën e kryeperëndisë), pra, të gjitha këto e bëjnë "Abaz Aliu" një përmendore të krijimtarisë naimiane dhe një perlë të poezisë shqipe. Për fatin tone të keq, kjo vjershë deri vonë s'ishte botuar në Tiranë. Kështu që një brez i gjithë, duke filluar nga 50-60 vjeçarët e poshtë, ende s'e njohin atë. Injoranca dhe brutaliteti komunist, ashtu si me gjithë kulturën e letërsinë, u sollën barbarisht edhe me Naimin e madh. Është naive të mendosh, se bilbilin e Frashërit diktatura komuniste e përkrahu, ndonëse i festonte përvjetorët, ndonëse e quante poet kombëtar. Jo, ajo e shfrytëzonte për qëllimet e veta apostullin e shqiptarizmit dhe kjo, pa dyshim, është një nga fyerjet më të mëdha që i është bërë Naimit dhe kulturës sonë kombëtare. Mjafton të kujtojmë për këtë se deri vonë dy të tretat e veprës naimiane s'ishin botuar ende në Tiranë si të papërshtatshme nga ana ideologjike. Por le të kthehemi tek "Abaz Aliu". Në këtë vjershë perlë, Naimi i madh, ashtu siç ndodh zakonisht në vjershat më të realizuara të poetëve të vërtetë, tejkalon konceptet e veta estetike, filozofike dhe fetare, për të na dhënë kështu një krijim, që në realizimin e tij të gjithanshëm, mund ta quajmë si një shkrepje gjeniale, si një fantaksje të magjishme, si një skulpturë rrezatuese. Ndërsa Sadik Bejko, në kumtesën e tij, 'Qerbelaja' e Naim Frashërit, aspekti historiko-simbolik i poemës', ndër të tjera theksoi: "...Qerbelaja", vepër e Naim Frashërit, botuar në Bukuresht më 1889, është një poemë epike me subjekt nga historia e Kalifatit arab. Poema shtjellon ngjarje që ndodhin në shekullin e IX-XV. Ngjarjet kryesore zhvillohen në luginën e Qerbelasë, në Irak. Treva e Qerbelasë si gjeografi shtrihet në një largësi prej 100 kilometrash në veri të Bagdadit, në kufi të shkretëtirës arabe, buzë lumit Euftrat. Aty, në tetor të vitit 680 nipi i Profetit Muhamed, Imam Huseni, u vra bashkë me 72 meshkuj luftëtarë të Familjes së Profetit, ndërsa femrat e tyre, të mbetura gjallë, u robëruan dhe u keqtrajtuuan nga ushtria e Jezidit, kundërshtarit fitimtar. Një gjakderdhje



e përmasave të tilla, therorizimi i kaq burrave të një familjeje, flijimi i fëmijëve dhe i grave, i bënë ngjarjet e fushës së Qerbelasë tërheqëse për poetët me frymëzim tragjik. Fusha e Qerbelasë tej e përtej e përgjakur jepte dorë për të thurur vepra epike të mbrujtura me frymë sublime. Si temë e zymtë dhe e madhërishtme, kjo do t'i shkonte përshtat talentit të një poeti siç

ishte Naim Frashëri, poet i dimensioneve tragjike dhe universale. Naimi e mori këtë ngjarje të ikonave themelore historikofetare të myslimanëve arabë, e mori këtë histori të largët Lindore e ktheu në poemë epike që fliste shqip, fliste dhe për shqiptarët. Qerbelaja... nuk janë vetëm shenja në histori, por dhe topikë në simbolikë, në idolatri. "Qerbelaja" e N. Frashërit nuk është vepër historike, është poemë epike himnizuese me mesazhe metafizike që nuk njohin hapësirë dhe kohë konkrete.

Ajo u flet të shtypurve të çdo kohe dhe të çdo hapësire, u thotë se si duhet vepruar nën dhunën dhe nën mizoritë e tiranëve. U thotë të shtypurve se ju, duke paguar me heroizëm, me gjak dhe me sakrificë sublime për një ideal të lartë, do të krijoni një kuazë të shenjtë që nuk do të harrohet kurrë ndër shekuj...". Në fund, shkrimtari Besnik Mustafaj, mbajti kumtesën "Lëvduar qoftë Naim Frashëri", ku ndër të tjera theksoi: "...Lidhur me fatin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, Naim Frashëri ka bërë me poezi atë që i vëllai, Samiu, ka bërë me prozën e tij filozofike dhe politike. E kam fjalën për shtjellimin e një platforme politike dhe ideologjike, e cila kishte për synim të vetëm e madhor zgjimin e vetëdijes kombëtare të bashkatdhetarëve të tij pas pesë shekujsh nën pushtimin osman. Siç e tregon fare qartë historiografia, ky zgjim ishte jetik për ekzistencën e mëtejshme të kombit shqiptar. Do mbajtur parasysh se jemi në çerekun e fundit të shekullit XIX. Të gjithë fqinjët tanë kishin fituar tashmë pavarësinë dhe, pasi kishin hedhur themelet e shteteve të tyre, po kalonin në një fazë të rritjes duke synuar zgjerimin e territorit. Kjo mund të bëhej vetëm në kurriz të trojeve të shqiptarëve. ... Ma merr mendja se Naim Frashëri, ndryshe nga i vëllai, Avdyli, nuk ka zbratur kurrë në jetën e tij një pushkë. Ai është ngjitur në piedestalin e heroit kombëtar vetëm përmes penës. Në këtë rast përkujtimor do të doja të përmendja edhe një aspekt. Një pjesë shumë e madhe e poezive kushtuar Naim Frashërit janë shkruar gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX..."



VITI I NAIM FRASHËRIT”, Tri dit rresht aktivitete në Tetovë

Prej 15-18 tetor 2020, në Tetovë u mbajt Edicioni i XXIV i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”. Ky aktivitet tradicional i përvitshëm, këtë radhë përfshihej në aktivitetet e tjera në kuadër të “Vitet të Naim Frashërit”. Përgjatë tri ditëve u mbajtën aktivitete të shumta letrare,

artistike, shkencore dhe kulturore. Në të morën pjesë poetë nga vende të ndryshme të botës si: Lidija Dimkovska (Maqedoni e Veriut), Bardhyl Maliqi (Shqipëri), Craig Czury (SHBA), Xhuzep Napolitano (Itali), Diti Ronen (Izrael), Françoise Roy (Kanada/Meksikë), Nikole Kazhë Florentini (Martinike), Puntorie Muça (Maqedoni e Veriut), Krystina Lenkovska (Poloni), Dalila Hiaoui (Maroko), Olimbi Velaj (Shqipëri), Poul Dabaard (Danimarkë), Elena Prenxhova

(Maqedoni e Veriut), Ida di Iani (Itali), Mitko Gogov (Maqedoni e Veriut), Ioana Gruia (Spanjë), Ana Bageriana (Ukrainë), Zosi Zografidu (Greqi), Dimitar Hristov (Bullgari), Daim Miftari (Maqedoni e Veriut), Sofia Skleida (Greqi), Arlind Farizi (Maqedoni e Veriut), Bujar Plloshani (Maqedoni e Veriut).

Hapja festive e Edicionit të XXIV të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit” u bë me anë të ndezjes së fishekzjarreve dhe flakadanëve që bartnin të rinjtë me veshje kombëtare shqiptare, para Qendrës së Kulturës, në Tetovë. Ndërkaq, buqetë lulësh u vendosën para shtatorës së poetit tonë kombëtar Naim Frashëri dhe një minute heshtje, në 120 vjetorin e vdekjes, iu dha poetit kombëtar Naim Frashëri.

Edicionin e XXIV të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit” e hapi drejtori i Festivalit, Shaip Emërllahu, i cili në mes tjerash, theksoi se, “Ky është viti i errët për njerëzimin. Pandemia ka përmbytur sistemin dhe kodin e të jetuarit. Ka rritur paqartësinë e të tashmes dhe të ardhmes. Jeta është privuar në masë të madhe nga bukuria e saj. Shoqëria jonë ka momentet e saj më të këqija stresive e depressive. Një fotografi e tillë është frikësuese. Ajo ka nevojë për vepra, të cilat do ta ndriçojnë njerëzimin, do ta fisnikërojnë dhe plotësojnë atë. Andaj, duhet besuar se, poezia (dhe artet tjera), duhet të flasin çdo ditë, që të mund të rruhet mendja e shpirti ynë...”.

Jurinë e Festivalit e përbënin, Prof. dr. Ymer Çiraku (kryetar), poeti dhe kritiku Remzi Salihu (anëtar) dhe Mr. Ndue Ukaj, (anëtar). Në natën e hapjes së Festivalit, titulli Anëtar Nderi i Festivalit i akordua poetes Puntorie Muça Ziba, ndërkaq çmimi letrar “Ditët e Naimit” iu dha poetit shqiptar Bardhi Maliqi. Në ditën e dytë të Programit, në sallën e Kuvendit Komunal të Tetovës me rastin e 120 vjetorit të vdekjes së poetit Naim Frashëri, u mbajt konferenca shkencore “Naim Frashëri dhe Atdheu”, ku studjues dhe poetë shqiptarë e të huaj

lexuan kumtesat e tyre, si Prof.dr.Ymer Çiraku, Prof.dr. Olimbi Velaj, Prof.dr. Belfjore Qose, Prof. Dr. Bardhyel Maliqi, Prof. Dr. Dije Demiri Frangu, Pierfranko Bruni dhe Xhuzep Napolitano (Itali) Prof. dr. Dalila Haioui (Maroko), Prof. Dr. Neli Naço, Dr. Haxhi

Shabani, Mr. Ndue Ukaj, Prof. Dr Izmit Durmishi, Prof. Dr. Arlind Farizi, Mr. Daim Miftari, Prof. Arjan Kallço, Prof. Xhelal Zejneli, kritikët dhe poetet Remzi Salihu, Bujar Plloshani, Puntorie Muça etj.

Sipas programit, në ditën e tretë u bë hapja e ekspozitës “Pelikani” me piktura të piktores shqiptare Flutura Maçi, si dhe u bë përrurimi librave të Sh. B. “Ditët e Naimit” si, “Shpella e Dantes” i Fiona Sampson, “Hëna e gjelbërt” e Tua Forstrom, “Ëndrrat e vogla” i Mohamed Rabie, “Dritë/

Luminance” i Belfjore Qoses, “Troja e kalit” i Shaip Emërllahu dhe Antologjia e Festivalit. Për këto vepra poetike folën kritikët letrar Remzi Salihu, Xhelal Zejneli, Remzi Salihu, Elena Prenxhova dhe Mitko Gogov. Në natën e tretë u mbajt ora e madhe letrare “Meridiane Poetike” u lexuan poezi dhe u ndanë çmimet e tjera letrare të Festivalit. Kështu, çmimi që jepet për vlera të veçanta poetike ‘Menada’ iu dha poetes shqiptare Olimbi Velaj, çmimi letrar ‘Oaeneum’ që jepet për ciklin më të mirë poetik iu dha poetes nga Spanja, Ioana Gruia, çmimi letrar ‘Qiri i Naimit’ që jepet për poezi më të mirë mori poeti Daim Miftari dhe çmimin letrar “Silke/Liria që jepet për shprehjen poetike, iu dha poetit Arlind Farizi.

Festivalin e udhëhoqi moderatorja Narta Emërllahu, ndërsa poezitë i lexoi në gjuhën shqipe aktori i njohur Arsim Kaleci. Nga një pikë muzikore ekzekutuan violinisti Shkëlzen Pajazit, me flautë dhe kitaristi përcollti leximin e poezive të poetëve.

Festivali u mbështet nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë, Komuna e Tetovës, restorant “Parajsa e Sharrit” dhe restorant “Kurtishi”.

D. Hadri



KALENDARI BEKTASHIAN (NËNTOR-DHJETOR 2020)

Nëntor 2020

- 5 nëntor. 120-vjetori i ngritjes së teqesë së Drizarit, Mallakastër (1900-2020).
- 10 nëntor. Pelegrinazh tek tyrbja e baba Hamzajt, Levan-Fier.
- 14 nëntor, përkujtohet baba Qamili, në teqenë e Melanit-Gjirokastrë.
- 21 nëntor. 120-vjetori i ngritjes së teqesë së Ngraçies-Mallakastër (1900-2020).
- 28 nëntor. Festa kombëtare e ngritjes së Flamurit.
- 28 nëntor. Përkujtimi i ish-Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Sali Niazi Dede, “Dëshmor i Atdheut”.

Dhjetor 2020

- 15 dhjetor. Përkujtohet 191 vjetori i ngritjes së teqesë së Turanit-Korçë.
- 21 dhjetor. 150 vjetori i teqesë së Matohasanaj, Tepelenë (1870-2020).
- 28 dhjetor. 5-vjetori i përkujtimit të kalimit nga jeta i baba Arshi Bazajt, i cili drejtoi teqenë bektashiane në Detroit, Miçigan të SHBA, (2015-2020).

PËRMET. “NATA E BARDHË NAIMJANE’ BASHKON NAIMIN FRASHËRIN DHE GJERGJ FISHTËN

E premte, 30 tetor 2020. Aktivitetet kushtuar “Vitet të Naim Frashërit”, në Përmet, ishte organizuar ndryshe, i konceptuar në formën e një konference shkencore, gërshtuar me recital me krijimtari të poetit bektashi, këngë, interpretime të ndryshme, kujtime e përjetime, me të njëjtin objekt. Ndër të veçantat e këtij aktiviteti, ishte bashkëpunimi i organizatorëve me institucionet kulturore të Rahovecit në Kosovë dhe Lezhës, duke ndërthurur (lidhur) ndërkohë përkujtimit dhe vlerësimet për dy kolosët e letrave shqipe, Naim Frashërit e Gjergj Fishtës.

....Pasditen e 30 Tetorit 2020, “ Shoqata Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare Vëllezërit Frashëri”, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Ministria e Kulturës, Bashkia Përmet, organizuan veprimtarinë përkujtimore:” Nata e bardhë Naimiane”, homazh me rastin e 120-vjetorit të ndarjes nga jeta të Naim Frashërit dhe 149-vjetorit të lindjes së Gjergj Fishtës në Qendrën Kulturore Multifunksionale “Odise Paskali”. Nga personalitetet e pranishme u bënë homazhe dhe u vendosën kurora me lule nga Bashkia Përmet, Prefektura Gjirokastrë, deputetë të Kuvendit Popullor, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Këshilli Bashkiak Përmet, Sekretari i Përgjithshëm i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, Nuri Çuni dhe



Shoqata “Vëllezërit Frashëri”, pranë bustit të Naim Frashërit.

Në këtë aktivitet morën pjesë dhe Kryetarja e Bashkisë Alma Hoxha; deputetja Mirela Kumbaro; Kryetare e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Lindita Rova; Kryetarja e Këshillit Bashkiak Përmet, Anila Mihali; nënkryetarët e Bashkisë Aulona Meshini e Florand Hasani; Kryetari i SHAK “Vëllezërit Frashëri”, Tomor Kotorri; Kryetari i KSHA “Naim Frashëri” Ligor Shyti; Kryetari i SHAK “Përmeti” Kastriot Bezati, Drejtori i Trashëgimisë Kulturore Lezhë Paulin Zefi; Drejtori i Kulturës i shoqatës “Zëri Dardan”, Rahovec, Bekim Kelmendi; Nënkryetari i Lidhjes LSHSH në Norvegji Hysen Berisha; Kryetari i KSHA “Ndoc Gjetja” Lezhë; Viktor Gjikkolaj, Prof.Dr.Asc. Zaho Golemi dhe drejtues të shkollave “Hydajet Lezha”. Lezhë, “Sami Frashëri” e “Meleq Gosnishti” Përmet etj.... Fjalën e mirëseardhjes dhe përshëndetëse në këtë veprimtari homazh e konceptuar si konferenc shkencore dhe recital poetik e mbajti Tomor Kotorri i cili uroj mirëseardhjen në këtë veprimtari dhe zhvillimin e saj me sukses. Në vazhdim kumtuam, historian

Kastriot Bezati “Mjeshtër i Madh”; poeti e studjuesi Lumo Kolleshi; deputetja Mirela Kumbaro; Alma Hoxha, Kryetarja e Bashkisë Përmet; Lindita Rova, Kryetare e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë; Nuri Çuni, Sekretar i Përgjithshëm i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane; Prof.Dr.Asc. Zaho Golemi; Viktor Gjikkolaj; Bekim Kelmendi etj... Recitalin poetik në vazhdim, e drejtoj poeti Lumo Kolleshi. Recituan poezitë e Naim Frashërit, nxënësit nga Lezha, Rosela Manshi, Rigers Dedëndreaj, Xhiliberto Gega, Aurela Misuli, përgatitur me nivel nga mësuesjan e letërsisë Ana Pali. Ndërsa gjeniu i vogël, Nikoll Prendi recitoj poemën “Bagëti e Bujqësi” të Naimit. Ndërsa nxënësit e shkollës “Meleq Gosnishti” të Përmetit, Estrieri Milo, Pamela Pashollari, Ordilda Jeon Mile, Elda Nasto, Aleksandra Qendro recituan poezi nga veprat e Naimit përgatitur nga mësuesja Kozeta Jashari; nxënësit e shkollës “Sami Frashëri”, Ester Shkurta, Marina Çuedari, Esmeraldo Metko, Katerina Todhe, Goljano Ilias, interpretuan pjesë nga “Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës”.

Në darkën e shtruar për nder të të ftuarve te lokal “Nemërçka” recituan poetët Nikoll Prendi, Sami Vëlçani, Viktor Gjikkolaj, Hysen Berisha, Haxhi Kalluci, Salvator Gjeçi dhe e Lumo Kolleshi. Poetët dhuruan libra. Paraditen e 31 tetorit, u bënë fotografi pranë bustit të



Naimit, ndërsa miqtë nga Lezha bënë pelegrinazh në Frashër, ku ndër të tjera, vizituan shtëpinë e vëllezërve Frashëri. TVSH-Gjirokastra dhe TVSH-Korça e pasqyruan gjerësisht këtë veprimtari, ndërsa medie e gazeta të tejtra qendrore, dhanë informacion për këtë aktivitet të rëndësishëm.

Në vazhdim, të pranishmit ndoqën panelin e kumtesave kushtuar "Vitet të Naim Frashërit. Tomorr Kotorri, Kryetar i shoqatës Adhetare Kulturore Mbarëkombëtare "Vëllezërit Frashëri": Kjo veprimtari kombëtare kulturore dhe shkencore, megjithëse është veprimtari e 19 që organizon shoqata jonë, vjen në vazhdim me një sërë veprimtarish të organizuara ndër vite, nga viti 2004 deri më sot, 30 tetor 2020. Tashmë kjo traditë e krijuar nuk duhet të shuhet, por të vazhdojë vit pas viti. Veprimtari të tilla ndër vite janë organizuar për figurat e shquara të historisë dhe kulturës tonë kombëtare, për Abdylin, Naimin dhe Sami Frashërin, Mithat Frashërin, Dritëro Agollin, Xhevahir Spahiun, akademikun Rexhep Qosja dhe Jorgo Bulo, ndërsa sot për të dy poetët atdhetarë, Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta dhe, vazhdimisht kemi gjetur mbështetje e institucioneve të larta shtetërore. Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta dy emra të mëdhenj, me status të padiskutueshëm mbarëkombëtar, dy emra monumentesh mendarë, me fuqi rrezatuese të pashterueshme, çlirues energjish të brendshme shpirtërore në pafundësi. Naimi vdiq më 1900, në



Naimi dhe Samiu janë doktrinerë të mëdhenj të kombit, të cilët shkrinë në një llogore të vetme tri detyrat themelore që shtroheshin para shqiptarëve një Vilajet Autonom dhe lëvrimin e kulturës atdhetare në shërbim të luftës për çlirimin e Shqipërisë. Më 16 prill 2010, ambasadori amerikan, John Withers II, i cili vizitoi Shtëpinë e Vëllezërve Frashëri, pasi u njoh nga ana ime me materialet dokumentare e fotografike të Muzeut të Vëllezërve Frashëri, ndër të tjera u shpreh: '...Vëllezërit Frashëri-Abdyli, Naimi dhe Samiu, janë burra për të gjitha kohërat ... Unë jam i nderuar që për pak minuta të eci aty ku ecën ata, të thith ajrin që ata kanë thithur dhe të shohë atë që kanë parë Vëllezërit Frashëri'. At Gjergj Fishta, në dy vitet e para të pushtimit nga fashistët e Romës nuk shkroi donjë varg për pushtuesit e vendit, përjashtuar vetëm gabimet dhe shkarjet e tij në jetën politike të këtyre dy viteve, edhe pse emri i tij është keqpërdorur në vitet e pasçlirimit, At Gjergj Fishta është vlerësuar nga jo pak studiues, ndër të cilët cilësojmë: nga Aleksandër Xhuvani, që e ka quajtur veprën e Fishtës një vepër lavdiplote, poet që e deshi dhe nderoi Shqipërinë, nga Sejfulla Malëshova, i cili, më 10 qershor 1945 dhe, edhe më vonë, siç shprehej Shefqet Musaraj, më 9 tetor 1949, i vlerësonte Faik Konicën, Nolin dhe Fishtën si figura të mëdha të Shqipërisë, nga Lasgush Poradeci, për të cilin Fishta ishte "Shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar", nga Dritëro Agolli, që e cilësoi poet që duhet të njihet patjetër, nga Moikom Zeqo, i cili më 13 qershor 2018 ka shkruar se Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta janë "kombndriçuesit e mëdhenj", nga Rexhep Qosja, që ka shkruar "Lahuta e Malcis" ... është një enciklopedi e tërë, për kulturën e gjerë që përmban vepra, si: historike, letraro-artistike, folklorike, etnografike...", nga Sabri Hamiti, i cili e cilëson At Gjergj Fishtën Hero të Kulturës përkrah Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit..."... Shqipërinë e ngriti, e lartësoi dhe i dha emër mbi tokë Gjergj Kastriot Skënderbeu, e mbajtën më këmbë dhe i ndriçuan rrugën e lirisë dhe të çlirimit Vëllezërit Frashëri, Abdyli, Naimi dhe Sami Frashëri dhe i

vuri mbi krye kurorën e vetëqeverimit Ismail Qemal Vlora. Lumo Kolleshi, poet, studiues: "...Në rrjedhën e historisë dhe sidomos në momentet më dramatike të saj, kur i është dashur drejtpeshimi i fateve të veta, kombi ynë ka gjetur pika të tilla referimi, që janë trupëzuar në një me vetëdijen, me vetëqëndresën dhe, me dritësinë e shkëlqimin e tyre, kanë ndriçuar rrugët e shpresës kombëtare. Një figurë me përmasa të tilla dhe gati më emblematiku është pa dyshim Naim Frashëri. Deri më sot poeti ynë kombëtar është kundruar nga naimistika për produktin e vet letrar, për rolin e vet si Rilindës e mësues i shqipes, për idealet e larta që mbolli për kombin apo si një ndër apostujt e bektashizmës, por pak ose aspak është marrë në konsideratë që Naim Frashëri, me madhëstinë e vet ka sjellë në letërsinë tonë motivin e poezisë kushtuar Naim Frashërit. ...Nëse për botën myslimane është një vend i shenjtë i quajtur Mekë dhe në përvitshmëri drejt këtij vendi organizohet një haxhillëk i përmasave të mëdha, për botën shqiptare ka dhe do të mbetet një Frashër, i cili ushquu me qumështin e vet çështjen kombëtare e Rilindjen e tij, ka midis tre vëllezërve një Naim Frashëri, që do ta kthejë pa dyshim Frashërin e bukur në Mekën e gjithë shqiptarëve. E kjo nuk besoj se do të mbetet vetëm një aspiratë. Kështu dhe vetëm kështu edhe brezat që do të vijnë më pas, do të plotësojnë poezinë e pambaruar kushtuar Naim Frashërit."

Mirela Kumbaro, deputete : "...Unë dua të falënderoj organizatorët për këtë aktivitet interesant, pjesë e aktiviteteve në "Vitin e Naim Frashërit", së pari shoqatën "Vëllezërit Frashëri, Kryegjyshitën Botërore Bektashiane, Bashkinë e Përmetit dhe të gjithë ata që kanë kontrubuar e mbështesin aktivitete të tilla. Përshëndes gjithashtu dhe miqtë tanë nga Kosova për ardhjen në vendlindjen e vëllezërve Frashëri dhe angazhimin konkret për këtë aktivitet, i quajtur "Nata e bardhë naimjane", i cili bëhet më i bukur e me më vlera, pasi bashkon dy korifenjtë e letrave shqipe, Naim Frashërin dhe Gjergj Fishtën. Historia kulturore e vëllezërve Frashëri nuk është vetëm histori e kulturës përmetare, por dhe asaj kombëtare e mbarëkombëtare. I takon Përmetit të zhvilloj aktivitete të kësaj natyre, duke bërë që nga aktiviteti në aktivitet, nga viti në vit, të sjellë një faqe të re nga trashëgimia e vyer naimjane. Siç e preka dhe më parë, është tejet interesante që vepra e tradita naimjane, sot sillen së bashku me vlerat e korifeut Fishta, që në esencë, na tregojnë se kjo pasuri është me gen të përbashkët shqiptar



pikëndarjen dhe pikëtakimin e shekullit të XIX me shekullin XX. Naimit i takon gjysmës së dytë të shekullit të XIX. Fishtes i takon gjysmës së parë të shekullit të XX. Së bashku kronologjikisht, zotërojnë një shekull të plotë krijimtari. Nuk është pak. Askush përveç të dyve, nuk janë së bashku një shekull. Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta, qenë megjithatë të ndryshëm. Njëri gegë dhe tjetri toskë, ata janë veriu dhe jugu dhe ndërsjelltas, sepse kombi shqiptar është vetëm një.

Kastriot Bezati, "Mjeshtër i Madh", Kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Përmeti": "Vëllezërit Frashëri, Abdyli,

dhe udhë-ndriçuese për brezat...

Alma Hoxha, Kryetare e Bashkisë Përmet: "...Është kënaqësi të jem pjesë e kësaj veprimtarie kushtuar dy poetëve të pandarë kombëtarë, Naim Frashëri e Gjergj Fishta. Kur nis të flasësh për këta, është vështirë të përzgjedhësh se çfarë është më e rëndësishme, pasi e gjithë jeta e tyre është e rëndësishme dhe flet më tepër se çdo fjalë. Të gjithë ata që kanë parë të paktën në qiellin e kulturës dhe letërsisë shqiptare, e dinë se këta të dy, janë dy poetët më të ndriçuar në këtë hapësirë të qiellit. Është shkruar shumë dhe do të shkruhet për këta patriotë e atdhetarë... Edhe sot nga distanca kohore i përkujtojmë si burim ideali, vullneti dhe veprimtar që ditën të shtrojnë dhe sintetizojnë perspektivën dhe objektiven, realen dhe të mundshmen, qëndresën dhe përpjekjen, fitoren dhe urtësinë. Vdekja e Naimit dhe ditëlindja e Fishtës, janë si të vendosura me dorë nga atësia dhe zoti pranë njëra-tjetrës. Janë si dy krenat e shqiptonjës për gjuhën tone, njëri gegë e tjetri toskë. Dy emra të mëdhenj me status të padiskutueshëm mbarëkombëtar, dy emra monumentesh mendor me fuqi rrezatuese të pashterueshme, çlirues energjish të brendshme në pafundësi. Naimi dhe Fishta janë misionar të pavdekshëm, ata janë komb-ndriçuesit tanë. Sa bukur kur je në vendin e Naimit, sa bukur kur ke dhe Fishtën në vendin e Naimit."

Lindita Rova, Kryetar i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë: "...Është bukur kur "Viti i Naim Frashërit, bën bashkë dy nga kollosët e shqiptarisë: Naim Frashërin e At Gjergj Fishtën.

Përmes referimeve në këtë konferencë do të kenë mundësinë të njohin veprën e tyre edhe nxënësit që marrin pjesë në këtë aktivitet, e jo vetëm ta njohin por edhe ta vlerësojnë e dashurojnë atë. Poeti ynë kombëtar Naim Frashëri lindi në 25 Maj të vitit 1846 dhe vdiq ne 20 tetor 1900, duke u varrosur në Merdiven -Koj pranë një teqeje të vogël në Stamboll. **Varrimi i tij i dytë** u bë më 3 qershor 1937 në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane në Tiranë me rastin e festimit të 25 vjetorit të Pavarësisë në një ceremoni madhështore të shtetit shqiptar dhe me interesimin e vet Mbretit Zog, i cili mori përsipër personalisht shpenzimet e sjelljes së eshtrave të tij prej Turqisë. **Varrimi i tretë** u bë në 9 prill 1940, nën pushtimin fashist italian, me rastin e 40-vjetorit të vdekjes së tij, nën kujdesin e Françesko Jakomonit (mëkëmbësi i mbretit Viktor Emanueli III për Shqipërinë) sërish në Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve në Tiranë, por në një varr të ri monumental të ideuar dhe financuar nga Jakomoni. Mbi mermer u vendos ky shënim: "Dhuratë e Shkëlqesisë së tij, Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Françesko Jakomoni"

Varrimi i katërt, u bë në 20 prill 1950 nga qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së poetit, në qendër të Tiranës aty ku janë ende sot tre bustet e vëllezërve Frashëri. **Varrimi i pestë** u krye në Tiranë më 10 qershor 1978 në kuadrin e festimeve madhështore për 100 vjetorin e krijimeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Varrimi i gjashtë... një dëshirë hipotetike e poetit, dëshirë me të cilën bashkohem me forcë edhe unë, që Poeti Kombëtar duhet të prehet përfundimisht një ditë aty ku lindi, në Frashër të Përmetit, duke e kthyer këtë fshat të shenjtë të Shqipërisë në një lloj Meke të shqiptarizmit..."

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, historian: "...Naimi është fytyra e zotit të shqiptarizmit. Naim Frashëri u bë një prej intelektualëve "osmanë" të shekullit të XIX me kulturë orientale e oksidentale, por mbi të gjitha autor i njëzet e tre veprave: pesëmbëdhjetë në gjuhën e mëmës në shqip, katër në osmanishte, dy në persishte, dy në greqisht.

Në kushtet e censurës dhe që mbante një post delikat si drejtor i këshillit të censurës në Ministrinë e Arsimit të Perandorisë Osmane, Naim Frashëri e pa të arsyeshme të mos përdorte emrin e mbiemrin në shumë nga botimet e veta, por të shënonte inicialet e tija por edhe të babait të tij, Halit beut: "N.H", "N.H.F", "N.F", pra përkatësisht Naim Haliti, Naim Halit Frashëri dhe Naim Frashëri, emër që tashmë e ka vulosur historia si "fytyrën e zotit të shqiptarizmit"! Vepra poetike e Naimit është veper e një titani kolos të shqiptarizmit. ..."

Në fund, z. Nuri Çuni falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët e këtij aktiviteti, duke dhënë ndërkohë mesazhet e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për vlerat e aktivitetëve të tilla cilësore, në kadrin e "Vitet të Naimit".

Kryegjyshi Botëror Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, takon përfaqësues të shoqatës dhe komunitetit Hebraik

Takimet e shumta me përfaqësues zyrtar e jo qeveritar të vendeve të ndryshme të Dede Edmond Brahimaj, i kanë shërbyer dhe po i shërbejnë përherë e më shumë njohjes dhe rolit të bektashizmit. Në këtë kuadër, më 29 tetor 2020, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj priti në një takim të veçantë përfaqësues të shoqatës dhe komunitetit Hebraik.

Miqtë shprehën konsideratat më të larta për Bektashinjtë, Kryegjyshatën Botërore Bektashiane dhe në veçanti për Kryegjyshin Botëror duke vlerësuar shumë marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet shtetit të Izraelit, Komuniteti Bektashi dhe Shqipërisë ndër vite duke e konsideruar një



"akt i shkëlqyer nga një vend i vogël që shëmbëllen vlerat e njerëzimit, sakrificën dhe dashurinë. Vlera që ende vijojnë të jenë të qenësishme në Shqipëri". Ata shtuan se nëse shumë kombe do të mësonin këtë pjesë të historisë së Shqipërisë, kjo do të ishte e shkëlqyer "Për ne hebrenjtë Shqipëria do të shërbejë gjithmonë si një farë bujarie, si një simbol fisnikërie, si një pishtar tolerance, si njerëz mikpritës."

Kryegjyshi Botëror Bektashian Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i falënderoj duke ju shprehur një mirënjohje të thellë për këtë vizitë dhe vlerësimet që dhanë për rolin e Klerikëve, Komuniteti Bektashi dhe Shqiptarëve ndër vite.

Vizitë e Ambasadores amerikane, Yuri Kim, në teqenë e Zallit, Gjirokastër

Më 26 shtator 2020, Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, zhvilloj një vizitë të veçantë në teqenë e Zallit, Gjirokastër. Ambasadorja u njoh me udhëtimin shpirtëror të bektashinjve që nga fillimet veta deri në ditët e sotme. Gjithashtu u bë me dije për sakrificat e panumërta të klerikëve bektashinj, kontributin e tyre për liri e pavarësi, urtësinë për t’iu afruar me devocion Krijuesit si edhe me sfidat e sotme të Selisë

së Shenjtë Bektashiane, si në kontekst të harmonisë fetare në Ballkan, ashtu edhe sfidat e lirisë së besimit dhe të fesë. Nga ana e saj, Ambasadorja Yuri Kim, duke e falënderuar për pritjen e ngrohtë, u shpreh se ishte kënaqësi e veçantë vizita në mjedise të tilla që frymëzojnë vetëm paqe dhe se marrëdhëniet midis SHBA dhe Bektashizmit do të jenë kurdoherë vëllazërore, në të mirë të paqes dhe të lirive fetare.



Vizita e Ambasadorit të Vatikanit në Shqipëri, Charles Johnes Brown, në Selinë e Shenjtë Bektashiane

Më 30 shtator 2020, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj priti në një takim të veçantë Ambasadorin e Vatikanit në Shqipëri, Charles Johnes Brown. Kryegjyshi e njohu ambasadorin me udhëtimin shpirtëror të bektashinjve prej vitit 1930, kur Qendra Botërore u vendos në Tiranë dhe deri më sot. Ambasadori u bë me dije gjithashtu për sakrificat e panumërta të klerikëve bektashinj, kontributin e tyre për liri e pavarësi si edhe urtësinë për t’iu afruar me devocion krijuesit. Kryegjyshi Botëror Bektashian Hirësia e

Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, e njohu ambasadorin edhe me sfidat e sotme të Selisë së Shenjtë Bektashiane, si në kontekst të harmonisë fetare në Ballkan, ashtu edhe sfidat e lirisë së besimit dhe të fesë. Nga ana e tij Ambasadori Brown duke e falënderuar Kryegjyshin për pritjen e ngrohtë u shpreh se ishte kënaqësi e veçantë vizita në mjedise të tilla që frymëzojnë vetëm paqe. Ai u shpreh midis të tjerave se marrëdhëniet midis Vatikanit dhe Qendrës Botërore Bektashiane do të jenë kurdoherë vëllazërore, në të mirë të paqes dhe të lirive fetare.



Ambasadori i BE-së Luigi Soreca në Malin e Tomorrit

Ambasadori i BE-së Luigi Soreca, më datë 30 nëntor të këtij viti, në shoqërinë e “Albania Rafting”, ka bërë një vizitë dhe është mrekulluar nga përjetimet me Malin e Shenjtë të Tomorrit. “Ngjitja në Malin e Shenjtë të Tomorrit ishte një përvojë e shkëlqyer. Nga maja 2416 metra e lartë, ju mund të shijoni dominimin e malit të shenjtë mbi peizazhin përreth, bukurinë dhe spiritualitetin e tij. Mbresëlënëse vizita në faltoren e Abaz Aliut. E mrekullueshme të zbuloja atë që quhet nga vendasit si “Sofra e Perëndive”, një platformë prej guri të bardhë e rrethuar me pisha dhe lisa. Faleminderit Albania Rafting, ata janë më të mirët!”, shkruan në statusin zyrtar Ambasadori i BE-së Luigi Soreca.



Për këtë vizitë dhe mbresat e saj, Ambasadorit Soreca, ka marrë dhe një letër falënderimi nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ndër të tjera, Kryegjyshi shkruan: “...Shumë i nderuar Ambasador Luigi Soreca! Nga media u informova që keni vizituar Malin e Shenjtë të Bektashinjve, atë të Tomorrit, të Abaz Aliut tonë

të Shenjtë. Uroj me gjithë zemër që ai vend i Shenjtë t’ju jap bekime e mirësi familjarisht dhe në misionin Tuaj fisnik që keni ndërmarrë. Më vjen vërtet shumë mirë që entuziazmoheni kur vizitoni këto vende e vakëfe të shenjta bektashiane dhe, nëse është në dëshirën Tuaj, Ju ftoj megjithë qejf edhe në vende të tjera të shenjta të bektashinjve, të shpallura monument kulture dhe të mbrojtura edhe nga shteti ashtu sikundër është maja e malit të Shenjtë të Sari Salltikut Krujë, nëse është interesante për ju, megjithë qejf, do t’ju shoqëroja në këtë udhëtim. Duke Ju uruar punë të mbarë e marshi uratat e bekimet më të mira nga Mali i Shenjtë i Tomorrit! Zoti ju bekoftë familjarisht! Amin!”

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj zhvillon takime mbresëlënëse në Paris

Çmojmë përpjekjet tuaja për paqe!

Me ftesë të z. Jean-Christophe Peaucelle, Ambasador për Çështjet Fetare në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme të Francës, në datën 8 tetor, në mjediset e kësaj Ministrie, delegacioni i Selisë së Shenjtë Bektashiane, i kryesuar nga Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u takua me miqtë francezë. Përveç Ambasadorit Peaucelle, në takim mori pjesë edhe z. Thomas Bertin, shef i departamentit të Ballkanit Perëndimor, pranë këtij institucioni. Në fjalën e tij të mirëseardhjes, z. Peaucelle, falënderoi Kryegjyshin Botëror Bektashian që iu përgjigj ftesës së tij dhe kujtoi takimin e parë të tyre në Tiranë, në kuadrin e një vizite pune, në kuadrin e perceptimit nga afër të harmonisë fetare në Shqipëri.

Ambasadori Peaucelle, theksoi gjithashtu se ishte në dijeni të faktit që Selia e Shenjtë Bektashiane, prej vitit 1930 që është vendosur në Tiranë, është shndërruar në një faktor të rëndësishëm bashkimi të shqiptarëve përballë luftërave ballkanike, si dhe të konsolidimit të bashkëjetesës dhe harmonisë fetare, në rajon. Ai u kujtoi të pranishmëve se marshimi i liderëve fetarë të Shqipërisë, pesë vite më parë në rrugët e Parisit, në kujtim të viktimave të Sharl-Ebdo, ishte një ceremonial jo thjeshtë prekës,

por edhe domethënëse. Përmes atij ceremoniali, ju përcollët mesazhin e madh se paqja fetare është plotësisht e mundur, se realitetet që jetojmë që jetojmë, kanë nevojë për përkushtimin dhe dashamirësinë e të gjithëve.

Pas kësaj, Ambasadori në fjalë, kërkoi të dinte diçka më tepër për klimën fetare në Shqipëri, si dhe rolin e Selisë së Shenjtë Bektashiane. Kryegjyshi Botëror Bektashian, nga ana e tij, pasi falënderoi miqtë për ftesën dhe pritjen e ngrohtë, tha se Shqipëria, përjeton vlera njerëzore dhe fetare që çojnë shoqërinë drejt unitetit dhe harmonisë. Prej kohësh, ne liderët fetarë, kemi ushqyer dhe ushqejmë tek ndjekësit tanë se nuk mund të ekzistojnë “Ne dhe Ata”. Ne jemi të gjithë njëlloj, pavarësisht teorive, doktrinave apo praktikave, ne i falemi një Zoti të Vetëm dhe ky është misioni i vetëm i fesë, të nxisë paqe e vëllazëri, të largojë mëri dhe zënka. Ne jemi përpjekur që jo vetëm t’i ruajmë vlerat themelore të lirisë fetare, por t’i çojmë ato më përpara, në ndihmë të sistemeve demokratikë.

Më tej, duke u ndalur në veprimtaritë e sotme të Selisë së Shenjtë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, u shpreh midis të tjerave: “Në thelb të besimit dhe praktikave tona, është dashuria për njeriun, pavarësisht kujt race i përket dhe çfarë feje ndjek. Në historinë e tarikatit të Islamit, ka pasur me mijëra të tillë, por që kanë humbur dhe ngatërruar rrugës. Ne kemi udhëtuar për 800 vite me radhë dhe ja ku jemi sot, shpresëplotë për misionin tonë, të shpërndarë anë e kënd botës, duke dhuruar urtësi dhe dashuri njerëzore. Prej disa vitesh ne po zhvillojmë takime me qeveritarë turq e grekë, me qëllim që teqetë e Haxhi Bektash Veliut (të cilat ndodhen sot jashtë kufijve politikë shqiptarë), të kenë mundësi t’u rikthehen misionit të tyre fetar, atij të edukimit të shpirtave me dijenitë hyjnore. Qoftë në Turqinë e sotme, qoftë në Greqinë e sotme, ka me dhjetëra-mijëra bektashinj, të cilët duan të shkojnë në këta tempuj besimi për të marrë forcë dhe shpresë, të lutën në heshtje, të mund të takojnë vëllezër e motra të tarikatit të tyre aq të dashur. Ne jemi të sigurt se këto teqe historike një ditë do të riçelen, duke na bashkuar akoma më shumë me njëri-tjetrin, si turq, grekë e shqiptarë. Personalisht besoj shumë në këtë të ardhme.”

Ndërsa pyetjes së z. Bertin se “cili është qëndrimi juaj si bektashinj, në konfliktin edhe fetar midis Serbisë dhe Kosovës”, Kryegjyshi iu përgjigj: “Historikisht, tarikati ynë ka shërbyer si urë lidhëse midis myslimanëve syni dhe të krishterëve. Përveç dokumenteve të arkivave ballkanikë, ka shumë udhëtarë apo autorë të huaj që dëshmojnë këtë fakt. Madje ka edhe shumë autorë francezë si: Justin Godart, Luis Jarey, Natali Klajer etj,



të cilët kanë vënë në pah këtë tipar të vyer bektashian. Në luftën midis Serbisë e Kosovës, u dogj me predha të artilerisë së rëndë krejt teqeja jonë në Gjakovë. Ishte mjaft e dhimbshme të shihje se si flakët përpinë në pak minuta, trashëgiminë kulturore dhe letrare më shumë se 300 vjeçare. Por ne si Seli Bektashiane, në qëndrimin publik pas kësaj ngjarje, thamë tekstualisht se “ata që dogjën teqe, xhami por dhe kisha serbe, duhet të dalin të gjithë përpara ligjit dhe të japin llogari. Besimi në Zot, i kujtudo qoftë, nuk ndanë, nuk përçanë, nuk djeg e shkatërron, vetëm bashkon.

E frytshme ishte dhe biseda me Ambasadorin tonë në UNESCO, z. Ferid Hoxha, i cili e priti Kryegjyshin Botëror Bektashian, i autorizuar dhe me porosi të drejtoreshës për trashëgiminë kulturore europiane në UNESCO, zj. Isabelle. Në fjalën e tij, Ambasadori Hoxha vlerësoi bektashizmin dhe në mënyrë të veçantë u ndal në veprimtarinë e përvitshme në Paris, në kuadrin e ditëlindjes së Naim Frashërit. Midis të tjerave, z. Hoxha tha se të gjithë mekanizmat në UNESCO, punojnë me idenë për të rrënjësuar paqe në mendjet e njerëzve, sepse çdo luftë fillon së pari në mendjet e njerëzve. Ai do t'i përcillte në çdo rast, me saktësinë më të madhe, çdo kërkesë të bektashinjve, tek zj. Isabelle Anatale-Gabriel, e cila për arsye të protokollit shtetëror të pandemisë, nuk do të merrte dot pjesë në këtë bisedë.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, në fjalën e tij, përmendi disa prej vlerave të trashëgimisë së shqiptarëve, të marrë në mbrojtje nga UNESCO, i bindur se një ditë, në këtë angazhim botëror, do të përfshihen

edhe dy-tri teqe që kanë bërë histori në krejt bektashizmin botëror. Ne do të jemi shumë të vëmendshëm dhe rigorozë, vijoi Kryegjyshi, në hartimin dhe përcjelljen e materialeve të dosjeve për këta objekte kulturi, të bindur se përmes tyre, përcillen mesazhe fetarë dhe njerëzorë që kanë bashkuar etni dhe raca, tek një Zot i Vetëm. Shqipëria vlen të krenohet se në gjirin e saj ka Qendrën Botërore Bektashiane dhe gjithashtu, duhet ti kushtoj më tepër vëmendje këtij fakti, në kuptimin e përgjegjësive historike që mbartim të gjithë.

Tepër e veçantë ishte pritja në Xhaminë e Madhe të Parisit, më 9 tetor, ora 12:00. Përfaqësues të lartë fetarë, e lutën Kryegjyshin Botëror Bektashian të falnin së bashku namazin e së premtes, duke u lutur së bashku për ditët e vështira që po kalonte, si gjithë bota, edhe Parisi. Kryegjyshi Botëror e pranoi me kënaqësi ftesën për t'u lutur së bashku, duke u shprehur se “jo rrallë jeta jonë na jep kënaqësi të tilla, të lutemi në një mesxhid me vëllezër myslimanë që i shohim për herë të parë”. Pas faljes, kanë qenë me dhjetëra e dhjetëra besimtarë parizien nga Egjipti, Maroku, Siria, Iraku etj, të cilët kanë rrethuar Kryegjyshin Botëror, duke e falënderuar atë për faljen shumë korrekte dhe duke bërë sa më shumë foto si kujtim i kësaj të premtjeje.

Më tej, ka qenë lideri i Xhamisë së Madhe të Parisit, njëherazi Rektor i Universitetit Mysliman, Shemsî Edine Hafiz, i cili ka pritur në selinë e tij delegacionin bektashian. Ai u shpreh i kënaqur që Kryegjyshi Botëror iu përgjigj ftesës së tij, i bindur se qoftë kjo lutje e përbashkët, qoftë biseda, do të kontribuojnë sadopak, në marrëdhëniet midis

Ndërsa pyetjes së z. Bertin se “cili është qëndrimi juaj si bektashinj, në konfliktin edhe fetar midis Serbisë dhe Kosovës”, Kryegjyshi iu përgjigj: “Historikisht, tarikati ynë ka shërbyer si urë lidhëse midis myslimanëve syni dhe të krishterëve. Përveç dokumenteve të arkivave ballkanikë, ka shumë udhëtarë apo autorë të huaj që dëshmojnë këtë fakt. Madje ka edhe shumë autorë francezë si: Justin Godart, Louis Jarey, Natali Klayer etj, të cilët kanë vënë në pah këtë tipar të vyer bektashian. Në luftën midis Serbisë e Kosovës, u dogj me predha të artilerisë së rëndë krejt teqeja jonë në Gjakovë. Ishte mjaft e dhimbshme të shihje se si flakët përpinë në pak minuta, trashëgiminë kulturore dhe letrare më shumë se 300 vjeçare.

dy institucioneve të Islamit. Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian e falënderoi Rektorin për ftesën si dhe për vendin e nderuar që iu rezervua gjatë faljes së namazit, në mesxhidin e Xhamisë së Madhe të Parisit. Ai u shpreh se jo rrallë, në historinë e Islamit, tarikatet nuk janë ndriçuar siç duhet, por në të vërtetë këta përbëjnë kurdoherë mozaikun madhështor të familjes myslimane. Ka pasur madje përpjekje përçarëse, duke dashur largimin e tyre nga xhamia, por kanë qenë të pa suksesshme. Tarikatet, siç është prej 800 vitesh bektashizmi, kanë qenë dhe mbeten degë të shëndosha në rrapin madhështor të Islamit. Ata marrin jetë nga të njëjtat burime si vëllezërit e tyre syni dhe do të jenë kurdoherë përkrah njeri-tjetrit. Për ne bektashinj të Shqipërisë, është hera e dytë që vijmë në Xhaminë e madhe dhe ndjejmë kënaqësi të veçantë. Urojmë që miku ynë i dikurshëm, Ebu Bakër, të gëzoj shëndet të plotë dhe një jetë të paqte pranë familjes.”

Rektori Hafiz, më poshtë u ndal në konceptin e harmonisë fetare, që sidomos në vendet perëndimore, nuk është e lehtë të arrihet dhe ndonëse përpjekjet janë disa planëshe, ndoshta rezultatet do të jenë të vonuara. E rëndësishme është që nga të gjitha kampet e besimtarëve të mos vijnë inate të ditës apo ironi të





zbrazëta, por mesazhe për bashkim e vël-lazërim, sikundër në të vërtetë kërkojnë Krishtërimi dhe Islami. Ndërsa duke u ndalur në situatën e harmonisë fetare në Shqipëri, Rektori u shpreh: “Krenohemi me ju, me bektashinjtë, me tarikatet e tjerë, me synitë shqiptarë, sepse ndonëse jeni shumicë numerike, prej shekujsh keni manifestuar vetëm mirësi dhe tolerancë. Në të vërtetë, në popujt me shumicë të një feje të caktuar, është e vështirë të vihet balanca për besimtarët e tjerë që nuk përbëjnë shumicën. Gjithashtu jam informuar që bektashinjtë e Shqipërisë me shembullin e urtë të tyre, prej kaq shekujsh, ndikojnë në harmoninë dhe vëllazërinë e kombit të tyre. Çmuj sinqerisht kontributin tuaj për paqe, edhe në betejat kundër radikalizmave apo përpjekjeve për politizimin e fesë. Ne do të jemi kurdoherë në kontakte të ngushtë, duke përcjellë mesazhe sa më inkurajues për njeri-tjetrin.”

Njëherazi në mbrëmjen e datës 9 tetor, delegacioni bektashian u prit në qendrën e konventës domenikane në Paris, prej Imzot Alberto Fabio Ambrosio, lektor primar në universitetin e Luksemburgut, autor i një libri mbi historinë e bektashizmit. Që në fillim, Imzot Amrosio, prezantoi shkurtimisht veprimtaritë fetare të konventës domenikane, duke u ndalur sidomos në rëndësinë që i kushtohet paqes fetare të sotme. Ai tha se ishte i emocionuar që kishte pranë Kryegjyshin Botëror Bektashian,, pasi kishte studiuar vite të tëra për këtë tarikat, ndërsa jepte mësim për teologji pranë universitetit të Strasburgut, madje kishte pasur takime me personalitete historik në rrafshin e studimeve bektashiane. Ai vijoi më tej,

duke thënë se takimin në fjalë e shihte si një bashkëbisedim të domosdoshëm me liderin e tarikatit kaq europian dhe paqësor.

Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror, i bëri një ekspozitë të qartë historike të bektashizmit, duke u ndalur sidomos në trevën ballkanike. Duke e falënderuar bashkëbiseduesin për kontributin e dhënë në studimet bektashiane, Kryegjyshi tha midis të tjerave: “Kontributi juaj, është padyshim, i çmuar. Pavarësisht se aty Shqipëria përmendet vetëm në rastin e Sali Niazi Dedeit, vërehet se njohuritë rreth këtij tarikati nga ana juaj, janë të thela. Bektashizmi në trevat shqiptare sot, ndodhet në trajtat e veta burimore. Ne i kemi përqafuar dhe përcjellë filozofinë dhe praktikën e prijësve tanë në formën e tyre më të plotë, duke ruajtur të paprekur substancën, midis të tjerave praktikën e moskrijimit të familjes biologjike, sigurisht në radhët e klerikëve. Për vetë kushtet kur lindën tarikatet përgjithësisht, për vetë prurjet e tyre doktrimore, prej popujsh, etnish dhe racave të ndryshme, bektashizmi ka manifestuar kurdoherë shenjtërinë e familjes shpirtërore, ngjashëm me atë të familjes biologjike. Gjatë udhëtimit të tij, sidomos në viset shqiptare, ky tarikat u bë shembulli më i qartë i ndjenjave të kulluara kombëtare dhe shpirtërore të Haxhi Bektash Veliut, u shndërrua në vatra të devocionit ndaj Krijuesit dhe dashurisë për kombin. Sot e kësaj dite, Qendra Botërore Bektashiane në Shqipëri, udhëheq me urtësi këtë tarikat, duke pasuruar traditat e tij shekullore.”

Një pritje e ngrohtë iu rezervua delegacionit bektashian më 10 tetor, në mjediset e Ambasadës së Republikës së Kosovës, në Paris, ku Ambasadori, z. Qëndrim Gashi e

falënderoi Kryegjyshin Botëror për vizitën dhe mesazhet paqësore që vijnë kurdoherë prej Selisë së Shenjtë Bektashiane. Ndërsa Kryegjyshi Botëror, vlerësoi misionin fisnik të diplomatëve të Kosovës, duke inkurajuar gjithashtu përpjekjet e të gjitha forcave politike, që lidhen me ardhmërinë e vëllazërve tanë, si dhe udhëtimin e përbashkët për në familjen europiane, në vendin që meritojmë.

Ndërkaq, shoqata kombëtare “Miqte e Shqipërisë” në bashkëpunim edhe me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Paris, z. Dritan Tola, shtruan më 10 tetor një drekë për nder të delegacionit bektashian. Kryetari i Shoqatës “Shtëpia e Shqipërisë”, z. Gjergj Themeli, e njohu Kryegjyshin Botëror me veprimtaritë e shumta të organizuara që konvergojnë në çeljen e ekspozitave të pikturave, diskutime librash të autorëve shqiptarë, promovime të këngëtarëve apo talenteve të ndryshëm instrumentistë. E rëndësishme, për z. Themelin, e rëndësishme ishte që këta artistë vinin nga Shqipëria, Kosova, viset shqiptare të Maqedonisë Veriore, apo Mali i Zi. Çdo vepër e tyre, shihet si një urë bashkëpunimi dhe integriteti i kulturës shqiptare me atë pariziene.

Gjatë bisedës së ngrohtë, Kryegjyshi Botëror falënderoi të gjithë nismëtarët e kësaj shoqate, i bindur se ajo shërben jo vetëm si vatër kulturore, por edhe si një shprehje e identitetit tonë kombëtar. Sepse vërtetë ne po trokasim fort në dyert e Europës, por vlen të jemi të denjë me ta, në çdo këndvështrim, duke ruajtur e çuar më tej, gjithçka të bukur që na lanë trashëgim të parët. Në fund, Kryegjyshi shtoi se: “Duke parë se këtu, tek kjo ‘Shtëpia e Shqipërisë’, vijnë nga gjithë trevat shqiptare, nga të gjitha fetë dhe besimet, më shkoi mendja tek teqetë tona. Edhe ato, kudo ku janë, presin e përcjellin besimtarë nga çdo vend i Shqipërisë, pa pyetur se cilës fe i takon. Në fund të fundit, jemi bij të një Zoti të Vetëm, jemi vëllazër të një gjaku dhe sidomos në këto kohëra ë po vijnë, vlen t’i ruajmë sa më fort vlerat e familjes shpirtërore dhe asaj biologjike.”

Vonë, në mbrëmjen e 10 tetorit, Kryegjyshi Botëror bëri një vizitë në spitalin ku merrte terapi piktori i njohur Omer Kaleshi, mik i vyer i bektashinjve. Ai këndoi një lutje duke i uruar shërim të shpejtë artistit të shquar shqiptar dhe duke e falënderuar për veprën e tij që i ka kaluar prej kohësh kufijtë e Ballkanit.

Syrja Xhelaj

Takime të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në Parlamentin e Kosovës

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, më datë 13 tetor 2020, zhvilloi dy takime të rëndësishme me parlamentarë e funksionarë shtetërorë të rëndësishëm të Kosovës. Takimi i parë u zhvillua me Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, përkatësisht me Kryetarin e Grupit Parlamentar, Rexhep Selimin, deputeten Flora Ujkani këshilltarin e grupit Salih Hoxha, ndërsa takimi tjetër ishte me Anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore të Parlamentit të Republikës së Kosovës.



Takimi me “Vetvendosja”

Më datë 13 tetor 2020, Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes ‘Vetvendosja’ Rexhep Selimi, së bashku me deputeten Fjolla Ujkani dhe këshilltarin e grupit parlamentar Salih Hoxha pritën në takim Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, Kryeshenjtërinë e tij, Haxhi Dede Edmond Brahimajn, Kryetarin e Gjyshitës së Kosovës, Mumin Lamajn, dhe kreun e Marrëdhënieve me Jashtë të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Arben Sulejmanin. Në këtë takim miqësor u fol për ligjin që ka të bëjë

me Liritë Fetare dhe sfidat për miratimin e tij, me ç’rast Selimi ia bëri të ditur Kryegjyshit Botëror, qëndrimin e Lëvizjes Vetëvendosja, që “përkrah njohjen e komunitetit Bektashi në Republikën tonë”. Komuniteti Bektashi në Kosovë ekziston ndër shekuj, dhe ka bashkëvepruar e kontribuar në krijimin e një të ardhme më të mirë në vend. Si i tillë, ky komunitet duhet t’i gëzojë edhe të drejtat që i gëzojnë komunitetet tjera fetare të njohura sipas ligjit në Kosovë, gjithmonë në respektim të ligjit dhe Kushtetutës së vendit, tha Selimi, i cili e falënderoi Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve për vizitën.

Takimi në Komisionit për të Drejtat e Njeriut

Anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticionet, u takuan sapo më 13 tetor 2020, me një delegacion nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, e udhëhequr nga Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Në takimi, përfaqësuesit e Selisë Botërore Bektashiane, me qendër në Tiranë, falënderuan anëtarët e Komisionit për pritjen e tyre dhe treguan interes të veçantë për Projektligjin për Komunitetet Fetare në Kosovë. Në vazhdim të takimit, Kryetarja e Komisionit, Znj. Duda Balje, vuri në dukje se Projektligji i lartpërmendur ende nuk

ka kaluar seancën e Kuvendit në leximin e parë, dhe se pritet që ky Projektligj të jetë në agjendën e Kuvendit të Kosovës sa më shpejt të jetë e mundur. se ky Ligj do të miratohet nga anëtarët e Kuvendit të Kosovës. Duke marrë pjesë në diskutim, Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, vuri në dukje se Bektashinjtë e Kosovës presin që statusi i tyre në Kosovë të zgjidhet ligjërisht së shpejti dhe se ata më në fund i dinë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre. nga Ligji i lartpërmendur për Komunitetet Fetare në Kosovë. Anëtarët e tjerë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet gjithashtu u kërkuan të ftuarve nga Selia Botërore Bektashiane, me qendër në Tiranë, pyetje të shumta në lidhje me punën dhe veprimtaritë e tyre si një e tërë.

Kremtohet pesëmbëdhjet vjetori i themelimit të Federatës së Paqes Universale.



Paqja: Rruga nga duhet të kalojmë

Përpara disa ditësh, rreth njëqind e tridhjetë ambasadorë për paqe nga Shqipëria dhe Kosova u mbledhën në Hotel Tirana International nën rregulla të rrepta sigurie për të kremtuar pesëmbëdhjet vjetorin e themelimit të federatës.

Aktiviteti u moderua nga Dr. Saemira Pino, antare e bordit të Federatës së Paqes Botërore dhe ish ministre e arsimit. Ajo theksoi kontributin e rëndësishëm që kjo federatë ka dhënë gjatë këtyre viteve në Shqipëri dhe në gjithë botën. Kryetarja e Asamblesë Kombëtare të federatës znj. Rajmonda Stefa përshëndeti pjesmarrësit dhe prezantoi disa nga veprimtaritë kryesore ndërkombëtare të viteve të fundit. Panelin e përshëndetjeve e çeli Shkëlqesia e Tij, ish President i Shqipërisë Alfred Moisiu, njëherazi Kryetari i Këshillit të Lartë për paqen në Ballkan, i cili midis të tjerave tha: “Unë e them me krenari që kam qenë pjesë e udhëtimit të Federatës së Paqes Universale që nga viti 2005, kur themeluesit e saj, Rev. dhe Znj. Mun, vizituan Shqipërinë si pjesë e turneut të tyre të inaugurimit të saj në 100 vende të botës, dhe i prita ata në rezidencën qeveritare në Durrës më 30 tetor 2005. Rev. Mun më

bëri përshtypje që në takimin tonë të parë me vizionin e tij largpamës dhe qasjen e tij të veçantë për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë familjare dhe fetare. Pas përfundimit të mandatit tim si President, me kënaqësi kam qenë pjesë e aktiviteteve kombëtare, rajonale dhe botërore duke u përfshirë në konferenca dhe samite të nivelit të lartë dhe them me bindje se Federata e Paqes Universale në këto 15 vjet ka arritur të bëhet një faktor ndikues në arenën ndërkombëtare.”

Folësi i dytë kryesor ishte Sh.T. Prof. Fatmir Sejdiu, Ish Presidenti i Kosovës. Në fjalën e tij Presidenti Sejdiu theksoi: “Besoj se është shumë e rëndësishme të shprehim vlerësimin tonë për punën e madhe që Federata e Paqes ka bërë për Shqipërinë dhe Kosovën gjatë këtyre viteve. Më duhet të them se puna e FPU-së është e jashtëzakonshme. Kam marrë pjesë në shumë veprimtari ndërkombëtare dhe të gjitha kanë qenë të shkëlqyera, por gjithashtu duhet të jemi krenarë për aktivitetet e nivelit të lartë që kemi organizuar këtu.

Unë besoj se me kapacitetet që ka FPU, me ardhjen e gjeneratës së re të udhëheqjes, fryma e saj do të vazhdojë

dhe me siguri ne do të adresojmë çështje të rëndësishme të cilat janë me vlerë dhe do të jenë të dobishme edhe për institucionet shtetërore.”

Paskëtaj fjalën e mori Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahima, i cili ndër të tjera tha: “Është krenari dhe privilegj i veçantë për mua, të përshëndes këtë audienc të nderuar dhe t`ju transmetoj urimet dhe mbështetjen e miliona besimtarëve bektashinj në të gjithë botën!

Paqja dhe besimi i Zotit qoftë e përjetshme në këtë botë të trazuar!

Veprimtari të përmasave të tilla, siç ka zhvilluar Federata e Paqes Universale, padyshim do të mbahen mend gjatë, jo vetëm për gjeografinë dhe problematikat që përfshin, por sidomos për substancën e mesazheve që përcjell ndër breza. Paqja Universale, ka qënë dhe do të mbetet ylli polar, që u tregon kombeve, religjioneve, sistemeve politike,

HIRËSIA E TIJ HAXHI DEDE EDMOND BRAHIMA: “Është krenari dhe privilegj i veçantë për mua, të përshëndes këtë audienc të nderuar dhe t`ju transmetoj urimet dhe mbështetjen e miliona besimtarëve bektashinj në të gjithë botën! Paqja dhe besimi i Zotit qoftë e përjetshme në këtë botë të trazuar!

Veprimtari të përmasave të tilla, siç ka zhvilluar Federata e Paqes Universale, padyshim do të mbahen mend gjatë, jo vetëm për gjeografinë dhe problematikat që përfshin, por sidomos për substancën e mesazheve që përcjell ndër breza. Paqja Universale, ka qënë dhe do të mbetet ylli polar, që u tregon kombeve, religjioneve, sistemeve politike, ekonomike dhe filozofike rrugën e mundimshme nga duhet të kalojnë.



ekonomike dhe filozofike rrugën e mundimshme nga duhet të kalojnë.

Shpreh bindjen e thellë se Federata e Paqes Universale me qendër në Tiranë, përmes veprimtarive madhore në këto 15 vite të themelimit të saj, ka ditur të manifestojë vullnetin dhe këmbënguljen në ndërgjegjësimin për një paqe të qëndrueshme dhe reale, duke nxjerrë në pah krenarisht shembullin e shkëlqyer të harmonisë dhe vëllazërisë fetare në Shqipëri.

Të 61 këshillat e paqes në të gjithë vendin, kanë frymëzuar përveç të tjerave, urtësinë dhe frymën e dashurisë për njeri-tjetrin, duke ndikuar në të sotmen dhe të nesërmen e Shqipërisë sonë.

Personalisht, edhe tani, që po përshëndes, ruaj mbresa të mrekullueshme nga Samiti i Paqes që u zhvillua në Tiranë vitin e kaluar dhe sidomos nga konsideratat e vyera për vendin tim, të dala prej Nënës së Paqes, Hak Xha Han Mun. Fjalë të tilla shpresëplotë i kemi kaq shumë të domosdoshme në këto kohra të vështira që kalojmë.

Prandaj duke i uruar edhe njëherë sinqerisht, punë të mbarë kësaj asambleje, me lejoni t`ju falenderoj të

gjithëve në këtë sallë, për kontributet në ndërtimin e paqes. Zoti ju bekoftë të gjithëve!”

Kryetari i Federatës së Paqes për Evropën dhe Lindjen e mesme, Dr. Katsumi Otsuka, dërgoi një video - mesazh për të përshëndetur të gjithë pjesëmarrësit. “E vlerësoj thellësisht kontributin tuaj të shkëlqyer për zhvillimin e themelit të FPU-së në Shqipëri dhe Kosovë. Dëshiroj të përshëndes punën tuaj të madhe për krijimin e Këshillave Lokale të Paqes në të 61 bashkitë e Shqipërisë. Unë besoj fuqimisht se të gjithë ju keni një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, jo vetëm në Ballkanin Perëndimor, por për të gjithë Evropën. Nuk mund të harroj atë që Nëna Mun, Bashkëthemeluesja e FPU-së, tha vitin e kaluar në Samitin e Tiranës, e cila theksoi rolin e Ambasadorëve për Paqen të Shqipërisë për ndërtimin e paqes në rajon dhe Evropë. Kanë kaluar 15 vjet që nga themelimi i FPU në vitin 2005 dhe tashmë ajo është zgjeruar kaq shpejt në të gjithë botën. Shpresoj që Federata e Paqes në Shqipëri dhe Kosovë do të vazhdojë të luajë rol kryesor duke mbajtur lart pishtarin e paqes dhe lirisë”.

Përgatiti Xhorxhin Çullhaj



VËLLAI YNË,

Shkollës 9-vjeçare në Godvi-Zerqan i jepet emri i baba Ismail Jangullit

Ndër shekuj, përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, figura të shumta kanë lënë gjurmë në shoqëritë ku ata kanë jetuar, por edhe me gjerë. Historia jonë dëshmon kontribut të madh të emrave të ndryshëm që janë skalitur në kujtesën e popullit, duke bashkuar brenda së njëjtës fotografi jo vetëm patriotë e dijetarë, por edhe përfaqësues të feve dhe besimeve të ndryshme.

Kleri shqiptar na ka lënë një nga pasuritë dhe traditat më të mira në botë, përsa i përket angazhimit të tyre jo vetëm në çështje fetare, por edhe në përpjekjet patriotike, kombëtare dhe ruajtjen e bashkëjetesës midis besimeve të ndryshme. Krahas ruajtjes së vlerave morale të shoqërisë, gjithashtu duhet vlerësuar fakti që ata kanë shërbyer si burim dijeje përgjatë gjithë historisë tonë.

Teksa kthehemi pas dhe shohim kontributin që përfaqësues të besimeve të ndryshme fetare na kanë trashëguar, sot vihemi përballë përgjegjesisë jo vetëm për t'i kujtuar dhe respektuar, por për t'i sjellë ata në vëmendjen e komunitetit dhe brezave të rinj, në mënyrë që ata të njihen me respektin që meritojnë.

I tillë ishte edhe Baba Ismail Jangulli, emrin e të cilit i kemi vënë shkollës 9-vjeçare Godvi në Zerqan, e cila tashmë është e rikonstruktuar tërësisht, me kushte më se të përshtatshme për një proces mësimor bashkëkohor për nxënësit dhe stafin pedagogjik.

Teksa investimi në fushën e arsimit vijon të jetë një nga prioritetet e Bashkisë Bulqizë, nuk mund të anashkalojmë emra të cilët kanë lënë gjurmë në edukimin e përgjithshëm të komunitetit, përfshi këtu edhe atë shpirtëror.

Vendimi për emërtimin e Shkollës 9-Vjeçare Godvi me emrin "Ismail Jangulli" u mor unanimisht nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, duke e vlerësuar Ismail Jangullin për kontributin që ka dhënë në fushën e arsimit, dhe më gjerë.

Në misionin e tij dhe të shumë klerikëve shqiptar ka ekzistuar një detyrë e dyfishtë, si për të restauruar mesazhin hyjnor, po aq edhe për ruajtur dhe zhvilluar dialogun vëllazëror ndërmjet feve të ndryshme.

Ai do të kujtohet si një nga arsimtarët më të përkushtuar në momentet kur nevoja për edukimin e brezave të rinj ishte shumë e madhe. Ismail Jangulli shërbeu si mësues i ciklit të ulët në vitet 1952 deri në vitin 1959 në fshatrat Lejçan, Ostren i Madh dhe Trebisht të Bulqizës.

Një tjetër vlerësim për Baba Ismailin ishte dekorimi me titull "Qytetar Nderi" nga ish komunat Fushë Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, si edhe urdhri i lartë "Naim Frashëri" më 10 Qershor 2019 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë Z.Illir Meta.

Sot ndihemi krenar që emri dhe vepra e tij do të mbeten në kujtesën tonë edhe përmes vendimit për ta emërtuar shkollën 9-Vjeçare Godvi me emrin "Ismail Jangulli".

Përulemi me respekt ndaj të gjithë atyre që jetën e tyre ia kanë kushtuar interesave madhore të shoqërisë tonë.

Nxënës, mësues dhe besimtarë bektashianë të Bulqizës, përjetuan këto ditë një ngjarje të shënuar, e cila lidhet me emrin e njeriut prej klerikëve të shquar të kësaj treve baba Ismail Jangulli. Ende kujtimi i veprës së këtij kleriku vazhdon të lerë gjurmë të pashlyera në shpirtat tanë. Me vendosjen e emrit të tij në shkollën 9-vjeçare të Godvis, përveç krenarisë së ligjshme, na bëhet se i kthejmë një borxh që i kishim vetë kalvarit të gjatë të jetës së këtij babai.

Nxënës dhe mësues të kësaj shkolle duke filluar nga këto ditë do të nisin mëngjeset e tyre shkollore me imazhin e gjallë të baba Ismailit, me respektin e thellë që ai pati për dijen, atdheun, udhën e ndritur të Haxhi Bektash Veliut. Ceremoninë e rastit e ka çelur Drejtoresha e Arsimit Znj. Ledjana Gjoka e cila pasi ka përshëndetur të pranishmit foli për nismën e marë si edhe mbështetjen e të gjithëve për vendosjen e emrit të baba Ismailit në shkollën e Godvis. Pas kësaj Kryetari i Bashkisë Lefter Alla përshëndeti Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve dhe gjithë të pranishmit. Në fjalën e tij midis të tjerave ai tha:

"Ndër shekuj, përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, figura të shumta kanë lënë gjurmë në shoqëritë ku ata kanë jetuar, por edhe me gjerë. Historia jonë dëshmon kontribut të madh të emrave të ndryshëm që janë skalitur në kujtesën e popullit, duke bashkuar brenda së njëjtës fotografi jo vetëm patriotë e dijetarë, por edhe përfaqësues të feve dhe besimeve të ndryshme. Kleri shqiptar na ka lënë një nga pasuritë dhe traditat më të mira në botë, përsa i përket angazhimit të tyre jo vetëm në çështje fetare, por edhe në përpjekjet patriotike, kombëtare dhe ruajtjen e bashkëjetesës midis besimeve të ndryshme. Krahas ruajtjes së vlerave morale të shoqërisë, gjithashtu duhet vlerësuar fakti që ata kanë shërbyer si burim dijeje përgjatë gjithë historisë tonë.

Teksa kthehemi pas dhe shohim kontributin që përfaqësues të besimeve të ndryshme fetare na kanë trashëguar, sot vihemi përballë përgjegjesisë jo vetëm për t'i kujtuar dhe respektuar, por për t'i sjellë ata në vëmendjen e komunitetit dhe brezave të rinj, në mënyrë që ata të njihen me respektin që meritojnë. I tillë ishte edhe Baba Ismail Jangulli, emrin e të cilit i kemi vënë shkollës 9-vjeçare Godvi në Zerqan, e cila tashmë është e rikonstruktuar tërësisht, me kushte më se të përshtatshme për një proces mësimor bashkëkohor për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Teksa investimi në fushën e arsimit vijon të jetë një nga prioritetet e Bashkisë Bulqizë, nuk mund të anashkalojmë emra të cilët kanë lënë gjurmë në edukimin e përgjithshëm të komunitetit, përfshi këtu edhe atë shpirtëror. Vendimi për emërtimin e shkollës

VËLLA I TË GJITHËVE



9-Vjeçare Godvi me emrin "Ismail Jangulli" u mor unanimisht nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, duke e vlerësuar Ismail Jangullin për kontributin që ka dhënë në fushën e arsimit, dhe më gjerë. Në misionin e tij dhe të shumë klerikëve shqiptar ka ekzistuar një detyrë e dyfishtë, si për të restauruar mesazhin hyjnor, po aq edhe për ruajtur dhe zhvilluar dialogun vëllazëror ndërmjet feve të ndryshme.

Ai do të kujtohet si një nga arsimtarët më të përkushtuar në momentet kur nevoja për edukimin e brezave të rinj ishte shumë e madhe. Ismail Jangulli shërbeu si mësues i ciklit të ulët në vitet 1952 deri në vitin 1959 në fshatrat Lejçan, Ostren i Madh dhe Trebisht të Bulqizës. Sot ndihemi krenar që emri dhe vepra e tij do të mbeten në kujtesën tonë edhe përmes vendimit për ta emërtuar shkollën 9-Vjeçare Godvi me emrin "Ismail Jangulli".

Përulemi me respekt ndaj të gjithë atyre që jetën e tyre ia kanë kushtuar interesave madhore të shoqërisë tonë."

Ndërsa Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj tha: "E kam pritur me kënaqësi të veçantë

dhe vlerësoj së tepërmi nismën e bashkisë tuaj, për t'i vendosur njërës prej shkollave, emrin e nderuar të baba Ismail Jangullit. Vlerësoj gjithashtu këtë fakt, i bindur se respekti për baba Ismailin, përcillet sot ndër breza të tërë klerikësh dhe besimtarësh të kësaj treve, të cilët janë shquar kurdoherë në devocionin dhe përkushtimin e thellë ndaj Krijuesit.

Baba Ismaili, biri juaj dhe vëllai ynë, i përket atij brezi të klerikëve bektashianë, të cilët u futën plot shpresa dhe plot ëndrra në udhën e Haxhi Bektash Veliut, duke menduar gjithmonë t'i falin gjithçka këtij tarikati. Ata hodhën krahëve harkanë e dervishit, me idenë për t'u shërbyer motrave dhe vëllezërve të tyre, për t'u zvogëluar brengat dhe për t'u shumëfishuar gëzimet. Ata i shndërruan teqetë e tyre, jo thjeshtë vende të mirëkuptimit dhe mikpritjes bektashiane, por edhe në kuvende të dashurisë për Zotin, për atdheun, për familjen, për këto troje të shenjtë për të gjithë.

Por viti i mbarshtë 1967, do të shkatërronte e do të dhunonte ëndrrat e krefit besimtarëve shqiptarë, të krishterë e myslimanë. Partia-shtet kishte llogaritur se me shembjen e tempujve fetarë, të krishterë e myslimanë, do të largonte



besimtarët nga rruget e Zotit dhe në atë fron të lartë, do ulëshin me radhë udhëheqësit e saj. Për të realizuar këtë obskurantizëm mesjetar, u morën lloj-lloj masash represive, deri në lançimin e klerikëve e besimtarëve, të cilët, të vetëdijshëm për misionin fetar nuk u trembën dhe nuk u tërhoqën.

Padyshim, në radhët e këtyre klerikëve bënte pjesë edhe vëllai ynë, i të gjithëve, baba Ismail Jangulli, i cili, as nuk qau dhe as nuk psherëtiu, por ngriti lart zërin, në mbrojtje të udhës bektashiane, të Ehli-Bejtit, të gjithë atyre që mbanin Zotin në zemra. Ai nuk u tremb as kur e arrestuan, as kur i krijuan lloj-lloj dramash familjare, as kur e dënuan gjoja në emër të pushtetit popullor. Klerikë si baba Ismail Jangulli, i dolën ballë për ballë diktaturës staliniste dhe 'ja numëruan' të gjitha në sy, pavarësisht dënimit të egër që e priste. Sot, është pak të thuash, se me përballjen e tij stoike ndaj regjimit, baba Ismail Jangulli ngrohu shpresat e vrara të krejt klerikëve dhe besimtarëve bektashianë, nga Dibra në Vlorë, nga Tropoja në Gjirokastrë.

Historitë makabre të burgjeve komuniste, kanë treguar e tregojnë me qindra raste të torturave çnjerëzore, përpara të cilave ka pasur plot që janë frikësuar. Por ka pasur burra dhe si Ismail Jangulli, që jo vetëm i përballuan këto tortura, por mbajtën të gjallë shpresën e bashkëvuajtësve të tyre, me fjalën e urtë të Zotit, me përluljen e thellë që na ka falur tarikati ynë 800-vjeçar. Kush e ka njohur vëllanë tonë në burgjet komuniste, mbanë mend fjalën e tij të ngrohtë e të lartë, qëndrimin kurdoherë të çiltër ndaj çdo besimtari, pavarësisht çfarë feje i përkiste.

Kontributi i baba Ismail Jangullit, vijon të shfaqet sidomos, në vitet 1990, atëherë filluan të fryjnë erërat e demokracisë edhe në Shqipërinë tonë të drobitur nga fukarallëku shpirtëror dhe ai material. Ai erdhi në vitin 1992 në Selinë e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, për t'iu bashkuar grupit të klerikëve e besimtarëve, të cilët rizguar besimin e fjetur dhe nisën plot vetëmohim punën dhe përpjekjet për gjallërimin e bektashizmit. I urtë dhe fjalëpakë, baba Ismail Jangulli, asnjëherë nuk foli për 'bëmat' e tij në regjimin komunist, përkundrazi, u vuri supet halleve dhe punëve të rënda, që kishin të bënin në mënyrë të veçantë me ngritjen e tyrbeve dhe teqeve të rrënuara. Për 'të, shikimi nga e ardhmja ishte busull e pagabueshme në të gjitha kohërat.

Konsakrimi me titullin e lartë "Baba" nga myrshidi ynë, Dede Reshat Bardhi, në fund të fundit ishte shpërblimi i një jete plot sakrificave vetjake dhe familjare, në dobi të udhës sonë, Udhës së Hakut. Ai e ka merituar kurdoherë atë titull fetar, duke u shndërruar në një baba aq të dashur jo vetëm për besimtarët e Shupenzës, por edhe ata ët Dibrës, Gostivarit, të Strugës, të Laçit dhe të Krujës. Këta qindra e mijëra besimtarë, njohën tek personaliteti i baba Ismail Jangullit, karakterin e pathyeshëm të çdo vështirësie, optimizmin përhershëm në çdo situatë, besimin e pa fikur tek filozofia dhe urtësia emblematike e Haxhi Bektash Veliu.

Teqeja e ngritur me kontributin e tij në Bllacë, është një tempull i shenjtë besimi, ku venë bektashinjtë nga e gjithë Shqipëria ku gjejnë ende kujtimet e mrekullueshme të bisedave me 'të. Baba Ismail Jangulli do të kujtohet me jetë e mot, jo thjeshtë për atë objekt të ngritur në prehër të malit, po për rizgjimën e traditës së vyer bektashiane, duke frymëzuar breza të tërë me dashurinë për Krijuesin, për jetën njerëzore, për vlerat e përgjeshme të familjes shpirtërore dhe asaj biologjike. Ai ka mbetur, pa dyshimin më të vogël, në memorien historike të bektashizmit shqiptar dhe atij botëror. Prandaj të dashur motra dhe vëllezër, dua t'iu falënderoj për nismën tuaj. Le ta gëzoj kjo shkollë emrin e baba Ismail Jangullit dhe të ruaj në breza kujtimin e tij! Uroj që gjithë mësuesit dhe nxënësit e kësaj shkolle, të bëhen po aq të denjë me jetën e tyre, sa ishte e denjë vetë jeta e baba Ismail Jangullit!

Zoti ju bekoftë të gjithëve!"

Pas ceremonialit modest, në kushtet e protokollit të pandemisë, mësues, nxënës dhe të ftuar bënë një vizitë në mjediset e kësaj shkolle duke u njohur akoma më shumë me traditat e kësaj treve si edhe jetën e baba Ismail Jangullit.

Koresp. Urtësia



Gjurmë të baba Bektash Golimbasisit në trevën e Vlorës



Tyrbja në Kurorën e Malit

Midis klerikëve bektashinj të trevës së Vlorës, në shek. XIX – XX, krahas baba Sali Matohasanit në Kuzum Baba dhe Kudhës Grehot, baba Ali Mesaplikut në Smokthinë, dervish Ramo Ballës në Gjorm, si dhe dede Ahmet Ahmataj në Brataj, një emër i përveçëm është edhe baba Bektashi i Golimbasisit.

Për fëmijërinë dhe rininë e tij duhen fare pak të dhëna. Por, Cane Ramaj, sjell në kujtesën e tij se baba Bektashi ka lindur në Kudhës Grehot, në vitin 1887. Babai i tij, që kishte qenë ushtar (rekrut) në viset e largëta të Anadollit, u kthye në vendlindje pas 9 vjetësh, pasi bëri ushtrinë edhe për vëllain e tij (bedel). Në ushtri kishte mësuar edhe zanatin e armëndreqësit. Kështu, ai mori famë, pasi rregullonte armët e komitëve në Mallakastër, Dhemblan, Kalivaç, Luzat e Kurvelesh, por edhe në Smokthinë dhe vise të tjera.

Krahas këtij zanati, ai kishte marrë dorë dhe ish bërë myhyb në teqenë e Haxhi Bektashit, kur shërbente si baba Haxhi Fejzi dedei, i lidhur ngushtë me besimtarët shqiptarë bektashinj. Në ato vite ai mësoi edhe gjuhët turqisht e persisht. Dy vitet e fundit të ushtrisë i kreu në rajonin e Kozhanit në Greqi.

Bektashi është fëmija i dytë, pasi djali i parë, vdiq në moshën dy vjeç. Pas pesë vjetësh lindi Bektashi, më 1887, për të cilin u tregua kujdes i veçantë në rritjen dhe edukimin e tij. Bektash Golimbasi pasi

mori mësimet e para në mejtepin e Beratit, vazhdoi edhe shkollën “Ruzhdie” po në Berat. Po aty, në vitin e fundit të shkollës, i është shfaqur Abaz Aliu dhe ky, në ëndërr fluturon nëpër mjegull e shi dhe i ishte dukur sikur ishte strehuar në një shpellë të malit të Tomorrit. Nga ku ankthi i gati një jave, me temperaturë dhe duke folur nëpër ëndrra, u lajmërua babai i tij, i cili mbërriti në Berat!

Pas një muaji, si u bë mirë, aty nga prilli maji i vitit 1900, hipur mbi një mushkë me babain e tij shkuan në tyrben e Abaz Aliut në Kulmak dhe bënë një kurban. Ata fletën tre netë në Kulmak, ku kuvenduan me dervish Iliazin dhe Muhib Hasanin nga Kolonja.

Ky takimi tyre me dervish Iliazin dhe muhib Hasanin, bëri të mundur që Bektashi të vazhdonte mësimet në Kajro. Kur u kthye që andej, pasi bëri vizita në shumë teqe në viset shqiptare, vendosi të marri dorë tek baba Shuaipi.

Ai ndonëse i vogël ishte njeri i ditur dhe bektashi me njohje të mëdha. Ai pati fatin të jetonte disa kohë me baba Sali Matohasanin. Kur ky u arrestua nga xhonturqit se përhapte libra shqip, bashkë me të ishin edhe dervish Sulua i Krahësit dhe Bektashi. U burgosën në Vlorë dhe pas 6 muajsh u liruan ndërsa Sali Matohasanin e bënë syrgjyn. Djali i teqesë së Golimbasisit, Bektashi ka bashkëpunuar ngushtë me Kanan Mazen, si dhe Ismail Kason në Dhemblan, Bektash Cakranin në Mallakastër e Ibrahim Selimin në Krahës të

Tepelenës, si dhe Rexhep Sulejmanin në Vajzë. Dervish Bektashi kishte miq të ngushtë edhe Gani Alikon në Shkozë, Rrapo Çelon në Sevaster dhe Bektash Ramon, me të cilët zgjidhnin hallet e krahinës së Kudhës – Grehotit. Në nëntor 1924 ata morën pjesë edhe në kuvendin zakonor të Kuçit, për pajtimin e gjaqeve që drejtohej nga Halim Xhelo e Sali Hallkokomi.¹

Dervish Bektashi i Golimbasit sa herë që vinte në Vlorë, strehohej në shtëpinë e Toli S.Arapit, i cili ishte një nga firmëtarët e kishës autoqefale Shqiptare dhe mik i ngushtë i Fan S.Nolit. Ishte e çuditshme se të dy së bashku, ngaqë e dinin mirë gjuhën turke, përkthenin materiale të bektashizmit. Një ditë që u ndodha edhe unë aty, më treguan një dorëshkrim ku kishin përkthyer jetën e Haxhi Bektash Veliut, ndërsa tjetra ishte “Historiku i Qerbelasë dhe shehitët e saj” rreth 25 faqe kuaderno (fletore). Në motin 1919-1920, kur ra gripi spanjoll dervish Bektashi diçka vite ka shërbyer edhe në Teqenë e Kuzum Babait në Vlorë. Është fakt, që në ndërtimin e Kishës së Shën Thanasit në Vlorë, kam financuar për ndërtimin e saj 34 veta nga paria e Vlorës, por edhe kisha katolike, hebretë (sinagoga) dhe teqeja e Kuzum Babait, ku ka nënshkrimin dervish Bektash Golimbasi. Pas Luftës së Vlorës 1920 dervish Bektashi u kthye përsëri në Kudhës Grehot.²

Fan Noli në Shkozë, 1923

Në vjeshtën e vitit 1923, gjatë viteve të lëvizjes demokratike shqiptare, u shpallën zgjedhjet e reja parlamentare për asamblistë. Babai im Gani Aliko, së bashku me atdhetarë të tjerë të Vlorës si Halim Xhelo, Myqerem Hamzarai, Rexhep Sulejmani, Rrapo Çelo, Kanan Maze ishin me krahun demokratik, shoqërinë “Bashkimi”.

Duke qenë se babai im çeli një gazetë “Djersa e Bujkut” me ndihmën e Halim Xhelos, për financimin e saj dhanë financime edhe baba Ahmet Turani dhe dervish Bektashi, që ishin miq të babait. Kjo gazetë, qysh në numrat e parë 1-3, shprehu interesat e fshatarësisë, hallet dhe problemet e tyre, mungesën e drithit, të rrugëve, shkollave e qendrave shëndetësore.


Jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra e krahina u ndez një debat i madh politik për të zgjidhur përfaqësuesit dhe intelektualët më të mirë për deputetë. Lufta politike kundër bejlerëve të feudalëve u ndez aq e ashpër sa që reaksioni feudal i çifligut vranë Adem Gjinishin dhe I. Kazazin të krahut demokrat. Në këto kushte, Fan S.Noli e Avni Rustemi, Halim Xhelua e Gani Alikua

1. Intervistë e marrë nga Cane Ramaj, vjeç 90, nga Shkoza – Sevasteri, 20 shtator 2016.

Në varrimin e Avni Rustemit në Vlorë, 1924 ishin ditë me tension të madh në qytetin e Vlorës, ato ditë të fundit të prillit 1924, ku pritej nga Tirana të vinte në Vlorë trupi i kryetarit të Shoqërisë Bashkimi, i cili u vra nga njerëzit e paguar të Ahmet Zogut (Isuf Reçit) në Tiranë.

Në Vlorë, atë ditë prilli pragosen mijëra vetë, asamblistët (deputetët) me Fan S.Nolin, Osman Haxhiun, Myqerem Hamzaranë e dhjetra të tjerë, por edhe përfaqësues nga krahinat e ndryshme të vendit. Midis tyre mbaj mend se pas Sulejman Delvinës dhe Osman Haxhiut, një kurorë me lule te varri i Avniut vunë edhe baba Bektashi e baba Ahmet Turani i Tepelenës.

2. Nga dorëshkrimi i Mihal Peço Doko, fletore 2, faqe 41-45, ruhet në familjen e të birit, Petraq Doko, Vlorë, shënimet janë të vitit 1947



nisën takimet në krahinat dhe qytetet e jugut të Shqipërisë. Pas takimit në Vlorë e Drashovicë, kishin lënë takim në Tepelenë, Turan dhe Kurvelesh. Një paradite tetori 1923, nga fshati Sevaster, erdhi beqiu i fshatit dhe lajmëroi babain, Gani Aliko se nga Sevasteri, te Rrapi, e kërkonte një prift pasi ishte prishur makina. Babai shkoi atje, por në shtëpi ne kishim mysafirë, pasi atë paradite ishte bërë pajtimi i gjakut midis një hekalioti dhe një dushkaraku. Në shtëpi, veç gjyshit Ahmet Aliko ishin edhe Rexhep Sulejmani, baba Ahmet Turani, baba Sulo Krahësi, Rrapo Çelo, Kanan Maze dhe dervish Bektash Golimbasi. Pas dy orësh edhe babai, vete në këmbë ndërsa në kalë kishte hipur prifti, që quhej Fan S. Noli. Atë natë u bë davet i madh, u therën dy desh dhe muhabeti për zgjedhjet parlamentare zgjati 5-6 orë. Pasditë, Fan S. Noli dhe baba Ahmet Turani dolën në koshtera. Noli vuri re diçka dhe tha: “A më bini një biçak” dhe duke bërë muhabet me baba Ahmetin mblodhi një tufë me lakra të egra. “E ç’do ato, more uratë”, e pyeti gjyshi Ahmet Aliko. Ai buzëqeshi dhe nuk foli. Kur u fut në konakë (shtëpi) iu lut gjyshit, që lakrat të përziheshin me miell misri e të piqeshin në tepsi. Noli nuk hëngri mish se ishte vegetarian, por vetëm 2-3 copë byrekë dhe një gotë verë. Të nesërmen, të gjithë siç ishim u hipëm kuajve e vamë në Krahës, Tepelenë dhe Turan, ku folëm për zgjedhjet. Në Tepelenë u poqën edhe me Avni Rustemin e Halim Xhelon.³

Emrat na i ka çuar baba Bektashi

Isha fort i vogël, kam lindur në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore. Familjet tona ishin të lidhura ngushtë me besimin

3. Intervistë e marrë nga Gëzim Aliko, dt.1940, djali i Gani Alikos nga Shkoza, Vlorë, 15 mars 1998.

Një paradite tetori 1923, nga fshati Sevaster, erdhi bekçiu i fshatit dhe lajmëroi babain, Gani Aliko se nga Sevasteri, te Rrapi, e kërkonte një prift pasi ishte prishur makina. Babai shkoi atje, por në shtëpi ne kishim mysafirë, pasi atë paradite ishte bërë pajtimi i gjakut midis një hekalioti dhe një dushkaraku. Në shtëpi, veç gjyshit Ahmet Aliko ishin edhe Rexhep Sulejmani, baba Ahmet Turani, baba Sulo Krahësi, Rrapo Çelo, Kanan Maze dhe dervish Bektash Golimbasi. Pas dy orësh edhe babai, vete në këmbë ndërsa në kalë kishte hipur prifti, që quhej Fan S. Noli.

bektashian. Kur vajta në klasën e parë në shkollë, prindërit më çuan te baba Bektashi, në teqe dhe i putha dorën. Aty mësova se emrin ma kishte vënë baba Bektashi për mbarësi. Ai më drejtoi në tyrbenë nga mali i Tomorit dhe unë u betova për Abaz Ali". Si mua edhe mjaft fshatarëve të tjerë si: Bexhet Shanaj, Telhai, Ali Rrapaj, Hysen Hoxha etj., emrin e kemi kujtim prej baba Bektashit.

Kur u rrita, në vitet 1957 – 1958, shkoja shpesh në teqe dhe e takoja baba Bektashin. Ai kishte lidhur te dora një laps kopjativ dhe në disa fletore italiane (kuaderno), priste fshatarët dhe përkthente "Sejahatname", në të cilën kishte shkruar si në ditar, rrugëtimet e tij në Kajro, Stamboll, Janinë, Selanik, Gjirokastër, Bursa, Anadoll, Kulmak, Prishtë, Teqenë e Zallit në Gjirokastër, në Malin e Kurorës, në Dorëz, Kuhës, Turan e Prishtë. Po kështu, në një fletore tjetër, shkruhej: "Istilahati sofijë", ku shpjegonte fjalët mistike në gjuhën shqipe.

Kur vdiq baba Bektashi në vitin 1961 u përcoll me nderime, fjalimin në varrimin e tij e ka mbajtur dede Ahmeti nga Brati.⁴

4. Intervistë e marrë nga Nedin Xhelili, vjeç 78, dhënë 14 gusht 2019.

DEDE EDMOND BRAHIMAJ, MERR PJESË NË EKSPOZITËN “NËNË TEREZA, SHENJTORJA SHQIPTARE”, NË KRYEMINISTRI



Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, më 4 shtator ishte i ftuar në çeljen e ekspozitën “Nënë Tereza, shenjtorja shqiptare”, që bëhej nën kujdesin e veçantë të Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Në këtë ekspozitë u afishuan në COD një prej dorëshkrimeve origjinale të Nënë Terezës me pasazhe në shqip. Ekspozita e çelur sot në COD në vigjilje të përvjetorit të shenjtërimit të saj, përmban tre dorëshkrime, të tri letrave të cilat i drejtohehin Ramiz Alisë, me qëllim ardhjen dhe çeljen e misionit të saj në vendin tonë, në një prej të cilave Nënë Tereza shkruan shqip, çka rrëzon edhe dyshime të shprehura nga studiues të caktuar, të kthyer në argumente banalë, lidhur me gjuhën e parë dhe amtare të Nënë Terezës, sipas të cilëve ajo nuk ka shkruar më kurrë shqip.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, vlerësoi këtë ekspozitë dhe rolin e Shenjtores Nënë Terezë.

KRYEGJYSHI BOTËROR, I FTUAR NË ‘FESTA E KULAÇIT E DOLLISË’ NË MOKËR



Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në datat 24-25 tetor 2020, ishte mysafir i nderuar i mokrarëve në aktivitetin tradicional “Mokra N’Festë!”.

Mokrarët festuan ashtu si vetëm ata dinë ta bëjnë me dolli dhe gatime tradicionale. Veshje popullore, performanca artistike, panair artizanësh etj. Viti i parë i një feste që do të bëhet traditë. Gjatë dy ditëve “Mokra N’Festë” u realizuan një sërë aktivitetesh, performanca muzikore,

kulinari, gatime mokrare, produkte pogradecare, etj. si: gatime tradicionale nga Mokra dhe Pogradeci, ekspozim të produkteve bujqësore dhe blegtorale, performancë, shoqëruar me vegla të ndryshme muzikore, ekspozim të punimeve artizanale dhe artistike, prodhim vere & raki e llojeve të ndryshme, performancë të grupeve folklorike, përpunimi i mishit dhe qumështit, birrat shqiptare, uji shqiptar, koktejl ushqimi dhe pije të zonës, hiking nëpër shtigjet e virgjëra dhe atraksionet kulturore që ka Zona e Mokrës (Gradishtë, Ura e Golikut, Varret e Selcës) etj. Ndër të tjera, në fjalën e Tij përshëndetëse, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj tha: “Jam shumë i nderuar që mora pjesë në këtë ceremoni kaq të bukur, ku treguam vlerat e kësaj krahine të lashtë, heroike, bujare, besim-dashëse dhe gjithë të mirat që ka bekuar nga Zoti. Edhe një herë, të gjithë bashkë, në këto kushte të vështira, në këtë pandemi, uroj dhe bekoj të dalim gjithmonë faqebardhë. Siç dihet jeta është luftë, lufta ka shumë beteja, dhe këtë beteje që kemi përpara besoj do ta fitojmë me ndihmën e Zotit, të gjithë bashkë. Unë uroj dhe bekoj, qofshi dritë! Zoti ju nderoftë të gjithëve që merrni pjesë në këtë ditë të bukur! Faleminderit!”

Botohet në shqip, libri Libri “Bektashinjtë shqiptarë. Historia dhe kultura e një rendi dervishësh në Ballkan”

TAKIMET ME ALBANOLOGUN E NJOHUR ROBERT ELSIE DHE PENGU PËR PROJEKTIN E MBETUR NË MES

Nga Kujtim BORIÇI

E shtunë, 5 shtator 2020. Kolegu, publicisti dhe studiuesi i arkeologjisë, Nuri Çuni, teksa po bisedonim në kafe, më zgjat një kopje-projekt të librit të albanologut të njohur Robert Elsie, të përkthyer nga anglishtja e përgatitur për botim në shqip nga një shtëpi botuese e njohur në Kosovë, duke më kujtuar takimin e kohëve më parë me Elsiënë dhe projektin e mbetur në mes, për shkak se ai ndërroi jetë. Libri në fjalë, është ai me titull ‘Bektashinjtë shqiptar’, i fundit që shkroi Elsie, të cilin (kopje e vetme) shtëpia botuese ja kishte sjellë për disa korrektime Çunit, i cili për gjashtë muaj rresht, kishte bashkëpunuar me Elsiënë për përgatitjen e këtij libri. “E pashë me kujdes, kam bërë disa korrigjime teknike, si saktësim drejtshkrimor të disa objekteve bektashiane, ndonjë datë, term fetar etj, e së shpejti do ua dërgoj. Është një periudhë bashkëpunimi, për të cilin unë kam shumë biseda me ‘të, shkrime me dorën e tij, mendime të ndryshme etj, që shpresoj ti hedh në një libër... Kur ndërroi jetë studiuesi, e sipas dëshirës së tij u varros në alpet e vendit tonë, në homazhet që u bënë në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, për shkak të mungesës së Kryegjyshit Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, me porosi të tij, unë së bashku me dervish Sali Petin, bëmë homazh dhe lamë shënime në libër dhe vlerësim ...” -më thotë kolegu Çuni. Në vazhdim, Çuni më kujton takimin në zyrën e tij me Elsiënë, atë ditë të bukur prilli të vitit 2007. Ishte takimi im i parë me albanologun (do të takohesha dhe herë të tjera me ‘të më pas), krejt i rastesishëm. Në një tavolinë, në zyrën e kolegut Çuni, pashë



një njeri të përkulur që shfletonte disa dokumente e mbante shënime, si dhe 2-3 të tjerë, në këmbë që po bisedonin me kolegun. I uluri në tavolinë që vazhdonte pa u shqetësuar, më la përshtypjen se ishte shumë më i moshuar se sa ishte në fakt. Bashkëbiseduesit që ishin në këmbë ikën. Mbetëm ne të tre.

-E njëj zotërinë që po punon në tavolinë- më pyet kolegu.

-Jo... Ndoshta si fytyrë e parë, por...- vazhdova unë.

-Është albanologu Robert Elsie, po punon këtu me ne për një libër që lidhet me bektashizmin- shtoi Çuni.

...U takuam, iu prezantova.

-O, po, të kam lexuar diçka, gëzohem që po takohemi dhe kështu- shtoi Elsie.

...Vazhduam gjatë bisedën atë ditë. U takuam dhe ditë të tjera. Kolegu e shoqëronte dhe në guida pune në krahina të ndryshme të vendit, tek objekte të kultit. Në një nga bisedat, Elsie më premtoi një intervistë të gjatë. Bile, një pjesë të saj e realizuam... Kishte një kërkesë Elsie dhe më kërkoi ndihmë nëse mund ta shoqëroja në disa fshatra shqiptarë në zonën Pogradec-Dibër, brenda e jashtë kufirit.

-Në dokumente të vjetra kam gjetur se në Qarish të, Frëngovë, Ladorisht deri në Dibër të Madhe, dikur ka pas ngujime autoktonë bektashinsh.. Dua të shkoj- më tha.

-Do gjemë kohën dhe do shkojmë-i premtova.

-E mirë, faleminderit. Shpresojmë të shkojmë sa më shpejt dhe kur të kthehem, e mbarojmë intervistën, e pasurojmë më shumë atë me fakte- tha si duke qeshur.


...Kaluan ditë, javë e muaj. Elsie lëvizi për punë. U befasova kur mësova se më 2 tetor ai ndërroi jetë (kishte lindur në Vankuvër të Kanadasë më 29 qershor 1950). Kishte lënë amanet që të varrosej në bjeshkët veriore të Shqipërisë, e kështu u bë. Mbeti pa u realizuar plotësisht projekti i përbashkët me të. Shpresoj që kolegu Çuni, që ka qindra faqe dorëshkrime të tij, biseda e shënime të përbashkëta udhëtimi, të botoj sa më shpejt librin e premtuar për 'të. Që të hidhet më shumë dritë mbi të famshmin Elsie, albanologun, shkrimtarin dhe përkthyesin që Shqipërinë e deshi aq shumë dhe ka lënë për 'të e shqiptarët një pasuri të vyer shkencore, historike e kulturore. Aq shumë e deshi, sa kërkoi që eshtrat e tij të prehen përjetësisht në tokën e saj.

Homazhi në bibliotekën kombëtare, Çuni, bashkë me dervish Sali Petin, me porosi të Kryegjyshit Botëror, lanë shënime në libër dhe vlerësim

Elsie: Ja pse e shkrova dhe çfarë përfshin libri për bektashinjtë!

Parathënie e studiuesit Robert Elsie

Ky vëllim i kushtohet rendit të dervishëve bektashinë në Shqipëri dhe rolit të tij në historinë shqiptare. Merret vetëm përçiptazi me bektashinjtë e Turqisë dhe gjetkë, për të cilët tashmë është shkruar shumë, edhe pse kryesisht në turqisht. Libri është i ndarë në katër seksione themelore. Seksioni i parë është përmbledhje e historisë dhe e kulturës së bektashinjve shqiptarë, që shërben si hyrje në lëndën, për të cilën shpresohet të jetë mjaftueshëm e përgjithshme për lexuesin mesatar, por që të përmbajë po ashtu detaje të mjaftueshme për të përmbushur edhe kërkesat e lexuesit "jo mesatar". Ky pasohet nga një seksion më i gjatë që paraqet një larmi shkrimesh mbi bektashinjtë shqiptarë nga udhëtarët e hershëm dhe studiuesit e shquar. Këtu janë të përfshirë shumë artikuj shumë të rëndësishëm që u qasen studimeve për bektashinjtë nga këndvështrime të ndryshme. Seksioni i tretë ofron një katalog të gjërë të teqeve kryesore dhe tyrbeve (faltoreve) të bektashinjve shqiptarë, të dhëna në mënyrë alfabetike sipas emrit të vendit, me informacione historike për origjinën, zhvillimin dhe rëndësinë, aty ku është e mundur. Katalogu nuk është aspak shterues pasi ka shumë faltore të vogla dhe teqe që nuk janë përfshirë këtu për shkak të mungesës së informacionit rreth tyre. Lexuesi do të hetojë se për disa teqe në këtë katalog, lënda është relativisht gjithëpërfshirëse, ndërsa për shumë të tjera ka boshllëqe. E tillë është gjendja e studimeve bektashiane për momentin.



Seksioni i katërt i këtij libri është një katalog i figurave më të shquara historike dhe legjendare të bektashinjeve shqiptarë. Përsëri, të dhënat biografike për disa nga këto figura është i paktë, por ne kemi dhënë këtu atë që mund të mblidhet. Korpusi kryesor i librit është rrumbullakuar me një fjalor të termave dhe një bibliografi për t'ia mundësuar lexuesit të interesuar që të ndjekë studime të mëtutjeshme në këtë fushë, nëse ai apo ajo dëshiron. Në këtë pikë, një fjalë falënderimi. Autori do të dëshironte të shprehte mirënjohjen e tij për Kryegjyshatën (Selia Botërore e Bektashinjeve) në Tiranë për ndihmën e madhe të ofruar. Falënderim në mënyrë të veçantë për Kryegjyshin gjithnjë të dobishëm, Haxhi Dede Edmond Brahimaj (Baba Mondit), sekretarin e përgjithshëm të Komunitetit Bektashian, Nuri Çunin dhe stafin e arkivave bektashianë. Një fjalë falënderimi duhet t'u thuhet edhe shumë njerëzve të thjeshtë bektashianë në malet e jugut të Shqipërisë që treguan mikpritje të madhe gjatë udhëtimeve të mia. Shumë prej tyre ishin në gjendje të sigurojnë shumë më shumë informacion mbi historinë lokale dhe faktoret sesa që kishim menduar. Ky vëllim i kushtohet rendit të dervishëve bektashianë në Shqipëri dhe rolit të tij në historinë shqiptare. Merret vetëm përciptazi me bektashinjtë e Turqisë

dhe gjetkë, për të cilët tashmë është shkruar shumë, edhe pse kryesisht në turqisht. Libri është i ndarë në katër seksione themelore. Seksioni i parë është përmbledhje e historisë dhe e kulturës së bektashinjeve shqiptarë, që shërben si hyrje në lëndën, për të cilën shpresohet të jetë mjaftueshëm e përgjithshme për lexuesin mesatar, por që të përmbajë po ashtu detaje të mjaftueshme për të përmbushur edhe kërkesat e lexuesit "jo mesatar". Ky pasohet nga një seksion më i gjatë që paraqet një larmi shkrimesh mbi bektashinjtë shqiptarë nga udhëtarët e hershëm dhe studiuesit e shquar. Këtu janë të përfshirë shumë artikuj shumë të rëndësishëm që u qasen studimeve për bektashinjtë nga këndvështrime të ndryshme. Seksioni i tretë ofron një katalog të gjërë të teqeve kryesore dhe tyrbeve (faltoreve) të bektashinjeve shqiptarë, të dhëna në mënyrë alfabetike sipas emrit të vendit, me informacione historike për origjinën, zhvillimin dhe rëndësinë, aty ku është e mundur. Katalogu nuk është aspak shterues pasi ka shumë faktore të vogla dhe teqe që nuk janë përfshirë këtu për shkak të mungesës së informacionit rreth tyre. Lexuesi do të hetojë se për disa teqe në këtë katalog, lënda është relativisht gjithëpërfshirëse, ndërsa për shumë të tjera ka boshllëqe. E tillë është gjendja e studimeve bektashiane për momentin.

Mirësitë e dervish Iljasit

Nga Nuri Çuni

Më 19 shtator të vitit 1875 lindi shpirtëndrituri dervish Iljasi nga Vërzhezha e Skraparit. Ai gjithë jetën e tij e shkriu për fe dhe atdhe, gjurmët e tij i kemi në gjithë Jugun e Shqipërisë. Një bamirës i rrallë, bëri rrugë, ura, çezma dhe ngriti teqenë e ktheu në një bujtësë, të rrallë duke i dhënë famë pelegrinazhit mbarëkombëtar dhe botëror në Çukën Abaz Ali të Tomorrit. Në veprat ndërtonjse është i rrallë, jo vetëm vizionar, se ç'farë duhet të bëjë, por me iniciativën e vet, se ç'farë shikon, që njerëzia vuan, për rrugë, ujë, ura etj. Kudo ku ndodhej, grumbullonte të gjithë njerëzit me bindje dhe dashuri, se, ura do bërë, çezma dhe puse duhen hapur. Gjithësesi, ai me shëmbullin e vet të paparë, u mësonte të gjithëve, se po iu përveshe punës, s'ka gjë që të mos bëhet. Ai këtë e theksonte se edhe Zoti këtë dëshiron, secili të punoj dhe të gëzoj frutet e punës së vet. Puna dhe vepra e tij, shumë mirë pasqyrohet në shtypin e kohës, që jep lajme, kronika, të punës së palodhur në veprat ndërtonjse kudo si në: Skrapar, Korçë, Kolonjë, Përmet, Tepelenë, Vlorë, Berat, Leskovik. Rrugët dhe urat për popullin e Skraparit ishin të vështira dhe të pakta, e vetmja rrugë e vjetër që quhej edhe rruga e Karvanit (e ndërtuar në kohën e romakëve kur hynë me legionarët e tyre edhe në brendësi të vendeve malore nëpërmjet luginave si: e Vjosës, Drinos, Osumit, Tomoricës, Shkubinit, të cilët ndërtonin udhë me kalldrëm, ura, mbas pushtimit të ilirisë). Dervish Iliasi kish udhëtuar shpesh në udhët e luginës së Osumit-Skrapar-Berat, lugina e Vjosë -Përmet edhe luginën e Tomoricës- Korçë-Kolonjë më këmbë dhe kafshë. Ai kishte parë rrugët e ngushta dhe pa rrugë, ura të prishura. Ai shikonte vuajtjet dhe vështirësitë e popullit, i cili vunte në këto udhëtime të gjata, prandaj i kushtoi një vemendje të veçantë ndërtimit të tyre. Shtypi i kohës jep një informacion intersant dhe të qartë për ndërtonjësën e rrallë, dervish Iliasi, shpirtmiri, humani, zëmërbardhi, bamirësi me vizion, bëri rrugë, ura, puse dhe çezma. Dervish Iljasi ndërtimin e udhëve në Skrapar sipas të dhënave të pleqëve por dhe burimeve historike i ka filluar në vitin 1906, ndoshta dhe më parë, se edhe shtypi i kohës jep një informacion të hollësishëm, si gazeta "Liria" 1909-1910 na informon se dervish Iljasi ka tre vjet me kazëm në dorë fshat më fshat bën dhe riparon udhë.

...Në një letër tjetër prej Frashërit nga Hasan Hoxha (mësues në Frashër) na thotë se "një dervish Iljas, bektashi nga Skrapari, ka dy vjet që po përpiqet për të ndrequr vendet dhe me kazmë në sup

fshat më fshat mbledh fshatarët dhe punon për këtë punë kaq të nevojshme. Dervish Iljasi kështu

ka ndrequr shumë rrugë dhe tani ka ardhur në kaza të Përmetit duke mos humbur asnjë ditë kot dhe duke dhënë të kuptojë botës se puna bëhet me të punuar vet, e jo duke pritur nga bota."

Nga hulumtimet tona, dervish Iljasi ka kontribuar në këto punime:

Udha këmbësore për karvane, Vërzhezhe-Çorovodë, në Skrapar, 1906.

Udha Gjurma Abaz Ali, Novaj, në Skrapar, 1906

Udha Vërzhezhe-Kulmak, në Skrapar, 1907.

Udha Shkalla e Bargullasit, Bargullas në Skrapar, 1907

Udha Bogovë-Novaj-Kulmak, në Skrapar, 1908

Udha Zaloshnjë-Kulmak, në Skrapar, 1908

Udha Poliçan-Bargullas, në Skrapar, 1909.

Udha Kolonjë, 1909

Udha e Kalldrëmit të Poliçanit, në Skrapar, 1909.

DERVISH ILJAZI
1875-1923

ME MIRËNJEREZISE
ESHTË AI QË BEN
ME TEPER NIRESI
NJEREZIMIT

Udha Kakos-Surropull-Frashër, në Përmet, 1910.

Udha Frashër-Përmet, 1910.

Udha Dushar, zona e Oparit-Korçë.

E shoh me vend të sjellë disa rreshta nga shtypi i asaj kohe:

I nderçmi Drejtor i gazetës “Lirija”. Shpirtmiri punonjësi i palodhur varfa Iljas, i cili edhe vjet të lajmërova, ka tre vjet me kazëm në dorë katund më katund, ku janë prishur udhët i ndreq dhe kështu: Skrapar, Përmet dhe në ca vise Kolonjë, Leskovik i ka bërë mirë. Sivjet doli përsëri, bëri një udhë që s’ta pret mendja, Surropull-Kakos ish një lumë (degë e lumit të Malindit) hidhej njëzetë herë; ato që hiqnin varfërija kur vinin në tregun e Frashërit! Udhën e bëri anës së lumit, katundarët punuan tri ditë; mbi këtë rrugë dhe ku gjen pak ujë dhe e bën krua.” ... Sidomos në këtë zonë kalonin banorët e fshatrave: Sevran, Rok, Malind, Muzhënçkë, Strenec, Qeshibes, Kakos, në këtë periudhë e më vonë. Ata bënë pazarin në Frashër, e cila ishte qendra e Dagëllisë së Përmetit. Për këtë gjendje shkruan Gazeta “Bashkimi, nr.18, e enjte 7 janar 1910, të ketë udhë qerreje nga Korça në Berat dhe rrugët Përmet, Skrapar, Tomor. Të kalojë në mal të Kakozit, duke ndjekur lumin Osum, në mullinj të e baba Xhaferit e në Çorovodë andej në Berat. Nga teqetë janë ngritur mullinj: Sukë, Çorovodë, Gërmënj, Backë, Dervishije të Përmetit (Gostomickë).

Dervish Iliasi para se të ndërtonte një urë, kish parasysh mendimet e popullit, shikonte me kujdes vahun dhe vendin ku ndodhte përmbajtje në fshatra. Merte mendimin e parisë së fshatit dhe grumbullonte vullnetarët për ndërtimin e urës. Fillonte së pari bërjen e furrave të gëlqeres (kamina) i digjte dhe më pas i shuante gurët e gëlqeres në gropa të posaçme, në afërsi të urës. Njëkohësisht priste drurët e drejtë për urën dhe siguronte lëndë tjetër drusore të stazhionuar, grumbullonte lesh dhije për të përzier me to, gëlqeren e shuar. Merte ustallarët më të mirë që dinin të bënin ura, si nga Panariti e vende të tjera. Lëndët e ndërtimit që përdorte ishin: gëlqere, rasa guri, lëndën e drurit, trarë, etj. Në fillim të ndërtimeve do siguronte lëndën e parë që ishte gëlqerja, për këtë organizonte punën. Kërkonte vullnetarë nga çdo familje e fshatit, i ndante në detyra: disa prisnin dru e shkurre, të tjerë punonin tek furra e gëlqeres. Në 4-5 ditët e para dervish Iljasi kujdesej të fillonte mbarë djegia e gurëve gëlqerorë. Mbas mbaronte djegia, i shuante gurët e gëlqeres në gropa të posaçme, afër ndërtimit që do bëhej. Në rastet e tjera dervishi do të caktonte një person për të ndarë në mënyrë të barabartë gëlqeren. Kishte merakun që secili t’i kishte shtëpitë të pastra brenda dhe jashtë saj të lyera me

gëlqere. Fjala puna dhe mendja e dervishit janë padyshim në:

Ura e Lapnit, Lapan, (riparim) në Skrapar 1910.

Ura e Sharovës (riparim), në Skrapar, 1910.

Ura mbi Vjosë në Tepelenë (1908).

Ura mbi lumin Shushicë, në Lubonjë dhe Penkovë, të Vlorës, në vitin 1909-1911.

Ura e Vlshës, fshati Vlshë, në Skrapar

Ura e Bogovës, Bogovë, në Skrapar.

Shamil Hamzaraj nga fshati Lubonjë i Vlorës, në kujtimet e tij shkruan: “Gjyshi im Ramadan Muhameti i dhimsej shumë sa herë dilte lumi Shushicë, në vahun e Kokojkës dhe mbyteshin njerëz. Ai iu lut Varf Iljasit dhe dervish Medin Gllavës që vinin shpesh në Lubonjë si mysafirë, të ndërtohej një urë mbi lumë. Dhe në motin 1909, varf Iljasi solli katër ustallarë nga Përmeti. Prenë lëndën e drurit në pyllin e Skotullës dhe punëtorët u gjendën në vend.” Në fshatin Lubonjë të Vlorës pranë lumit Shushicë përballë lagjes Penkovë ishte vahu i Skënderbeut. Urën që shpëtoi jo vetëm banorët e fshatit por të gjithë zonën dhe fshatrat e largëta të Vlorës. Banorët i shprehën me shqetësim dervish Iljasit në vitin 1909, se në lumin Shushicë mbyteshin fëmijë, të rritur, pleq ishte bërë një shqetësim i madh, tragedi ndër vite. Menjëherë dervishi me dashurinë për banorët organizoi takime me parinë e fshatit dhe pa me kujdes, vahun e Skënderbeut, vendi më i arsyeshëm për të ndërtuar urën, vendi ishte i rrethuar me kodra të vogla dhe i mbushur me pyll lisi. Së pari zgjodhi ustallarët më të mirë, kish edhe nga Panariti i Korçës dhe Gjirrokastër punonin çdo ditë 17 ustallarë dhe 25 punëtorë. Kurse të shtunën dhe të dielën punonin vullnetarë 200 vetë. Siç tregojnë pleqtë e vjetër dervish Iljasi këtë urë e bëri me 7-8 këmbza me bazament guri në formë rrombi, të cilat luanin një rol të rëndësishëm për përbalimin e vërshimeve të ujrave të lumit Shushicë.

I ndjeri Hekuran Sanxhaku nga të dhënat e nënës së tij, Bejaze, që ka jetuar gjatë në Vlshë, e cila i ka përjetuar të gjitha ngjarjet historike të fshatit dhe e ka njohur dervish Iljasin. Nëna më thoshte: “Para se të fillonte ndërtimin e urës, dervish Iljasi, mori mendimin e parisë të zonës së Potomit, që quhej edhe Skrapari i Sipërm se si do organizoheshin ndihmat e popullit për të bërë urën e Vlshës. Së pari organizoi djegien e furrave të gëlqeres për rreth pyllit të fshatit, ku edhe sot i thonë Përroi i Furrës. Kjo urë mbi lumin e Kapinovës që rrjedh nga malet e Ostrovicës dhe degët e tjera, deri ku kufizohen me Tomoricën. Atje krijohet në dy krahët e maleve peisazi i një lugine të shkurtër që qarkohet nga fshatrat Faqekuq, Kapinovë, Krast, Bërsak,

Turbohovë, Krushovë, Gostënkë, Leshnjë dhe Vlshë. Aty ku vahu i lumit ngushtohet përfund fshatit Vlshë në jugperëndim, në afërsi të Osojës, Pikërisht në këtë vend dervishi mendoj ndërtimin e urës. Për ndërtimin e saj janë gjetur specialist më të mirë të punimit të gurit të zi dhe është përdorur gëlqere e shuar vite më parë, kjo gëlqere është përzier me lesh dhie dhe i ka rezistuar kohërave dhe do t’i rezistojë shekujve të ardhshëm. Kjo urë është ndërtuar me tre këmbëza, ku këmbëza e mesit ka formën e një trekëndëshi, e cila shërben për të përcjellë ujin e rrëmbyeshëm dhe inertet e tjera, që sjell lumi me furi në dimër nga malet e lartë të Ostrovicës dhe malit të Leshnjës. Ura është e gjatë 10 m, lartësia sot 2.15 m, se vitet kanë bërë mbushjen e saj. Gjërësia e urës është 2.5 m.

Mendja e artë e dervish Iljasit la gjurmë edhe në ndërtimin e puseve. Për të bërë një pus, ky shikonte me kujdes mjedisin përreth, ku kryqëzoheshin udhët, në rrugë kalimet e ndryshme, që udhëtari në një ose një orë e gjysëm të kish ujë burimi ose pus, këtë punë, ai e bënte për t’i ardhur në ndihmë udhëtarëve dhe barinjve. Puse që ideoi dhe ndërtoi janë: Pusi te Mëni fshati Vërzhezhë, në Skrapar.

Pusi në lagjen Qafok, riparim i plotë, fshati Vërzhezhë, në Skrapar, në vitin 1913.

Pusi në Pirogosh, në Skrapar.

Pusi në hyrje të Grykës Dëvri, në Skrapar.

Pusi në të dalë të Grykës Dëvri, në Skrapar.

Pusi në fshatin Vlshë, lagje Mançe, në Skrapar.

Pusi në fshatin Dushar në Korçë.

Pusi në fshatin Surropull, në Përmet.

Pusi në fshatin Podë, në Kolonjë.

Dervish Iljasi ka një veprimtari gjithëpërfshirëse në vite si: fetar, bamirës, ai hapte puse, ndërtonte rrugë, bënte çezma, pajtonte grindje dhe mëritë në çdo fshat. Ai përhapte diturinë me punë dhe djersë, ndihmonte në hapjen e shkollave dhe ishte në krye të veprimtarive për arsimin dhe lirinë e Shqipërisë. Si bamirës erdhi edhe në fshatin Radësh dhe Koritë dhe bëri puse e çezma, ishte kërkuesi i ujit. Në një takim të rastit, një udhëtar nga Labëria, mbi Pirogosh takoi dervish Iljasin dhe bëri një bisedë interesante, e midis të tjerave udhëtari shtoi, ky vend i bukur do edhe ujë. Ai u largua për në Korçë në hallin e tij. Të nesërmen dervish Iljasi mblodhi banorët e fshatit e u tha për hapjen e një pusi në fund të Radshit. Aty ku i thonë Pirogosh, e hapi të thellë 13 metra, mori si specialist Hasan Gurin nga Radëshi, i cili ishte punëtor i rrallë. Kur përfundoi së hapuri pusin, dervishi mori dy fidana lisi, i fërkoj mbas shpatullave të tij (i bekoi) duke thënë: “Lisat do të rriten për hije, të pushojnë udhëtarët e lodhur,

pranë pusit me ujë". Udhëtari që u kthye mbas shumë ditësh e gjeti pusin të hapur, piu ujë dhe u freskua i lumturuar, mori vesh se këtë pus e kish bëri dervish Iljasi. Pastaj u shpreh: "Unë mora bekimin e dervishit." Gjithë udhëtarët që vinin nga Çorovoda në të përpjetën e Pirogoshit aty do shlodheshin e freskoheshin me ujin e pusit të dervish Iljasit. Jo vetëm kaq por dervishi caktoi kujdestar Hasan Gurin, në mirëmbajtjen e pusit, i cili e paisi me çikrik, kovë dhe gjatë gjithë vitit kish ujë të pishëm. Ky vend sot është i vizitueshëm për të gjithë edhe turistët e huaj, që kërkon jo vetëm mirëmbajtje por të shërbej për mesazhin e madh që la dervish Iljasi në shërbim të njeriut dhe popullit. Dervishi i kish menduar mirë zgjedhjen e puseve në rrugë kalimin Çorovodë, Grykën e Dëvrisë për në Tomoricë, pasi i parë në Pirogosh, në grykën e Dëvrisë hyrjen dhe daljen e saj. Ai e shoqëroi me pusin e dytë në hyrje, te Lajthitë e Dëvrisë dhe i treti mbasi mbaron Gryka e mrekuellueshme ose mbi fshatin Përrenjas, ku duket mjedisi gjeografik, si një perlë e veçantë tomoriane. Udhëtarët kishin mundësinë të shuanin etjen për tu freskuar. Në këtë rrugë, dervish Iliasi kishte takuar shumë herë barinjtë, udhëtarë të ndryshëm dhe kish marë mendimin se ku duhej ujë. Zgjedhja e pushimit të dytë te Lajthitë e Dëvrisë ishte e veçantë, sepse ishte një pikë lidhëse për banorët me Gradecin, Vlushën, Osojën, Potomin me pjesët e tjera të Vërzhezhës, Radëshit dhe udhëtarët që vinin e shkonin në Korçë.

Dervishi ishte kërkues i ujit. Ai dinte të dallonte nga prania e bimëve të ndryshme të ujit, zhuka, shpëndra, shelgu dhe bime të tjera, se ku mund të kish burime, shikonte luginat, përrenjtë në gjatësinë e tyre, gjelbërimin. Me kujdes ndërtonte kanale, në thellësi sipas vendit, bënte llagëm me gurë dhe me zhavor, e nxirte burimin ose çezmën në një vend të dukshëm e të ngritur. Ai i bënte të thjeshta me gurë ose kup guri, dhe kur kish mundësi ngrinte dy sofat në krah të çezmës, si rasti në çezmën e Koritës, Vërzhezhës dhe Frashërit. Ai është nismëtar i ndërtimit të këtyre çezmave:

- Çezmë në Rripaz të fshatit Vërzhezhë, Skrapar.
- Çezmë në Krorëz të fshatit Vërzhezhë, Skrapar.
- Çezmë në rrugën Vërzhezhë, Kulmak, Skrapar.
- Çezmë në Prosek, Skrapar.
- Çezmë në fshatin Novaj-, Skrapar.
- Çezmë në fshatin Nishovë, Skrapar.
- Çezmë në fshatin Nishovë, Skrapar.
- Çezmë në fshatin Koritë, Skrapar.
- Çezmë në fshatin Mollas, lagja Lamçellarë, Skrapar (1918).
- Çezma e Shkurtëz, në Kulmak, Skrapar.
- Çezmë te Përroi i Peshkut, lumi Tomoricës afër Konakut, Skrapar.
- Çezmë e thatë, në Uznovë, Berat.
- Çezmë në fshatin Lavdar, Korçë.
- Çezma e Gurit të Prerë, Tomoricë, Skrapar.
- Çezmë në Opar afër Vrepçkës-Korçë.
- Çezmë në malin e Dusharit, Korçë.

Vjehrra e Riza Alimerit në Dobrenj kur ishim me Xhevahir Spahiun (udhëtimi rreth Tomorit gusht 2003) tregon se dervish Iliasi ishte ilaç, pranë njerëzve dhe halleve të popullit. Ja atje te përroi i Peshkut në lumin e Tomoricës, poshtë pazarit të madh, që bëhej çdo të diel në Konak, ai ndërtoi një çezmë për gjithë udhëtarët, që vinin nga fshatrat e Gramshit në zallishten e lodhshme të lumit Tomoricë. Por jo vetëm kaq, ai edhe në afërsi të Qafës së Gjarprit ndërtoi çezmën në anë të rrugës që kalonin udhëtarët në rrugën kryq midis Korçës, Gorë Oparit dhe Skraparit, që do kalonin në pikën e njohur, Guri i Prerë me histori. Ai bëri çezmë edhe në malin e Dusharit për barinjtë e fshatit. Në një fshat të Frashërit ishte një çezmë e madhe, ujë me bollëk. Aty mbushte ujë gjithë fshati, aty vinin e pinin dhe bagëtitë. Dervish Iliasi, kalon

dhe sheh radhë të gjatë të grave, që prisnin për të mbushur ujë. Qëndron, freskohet e në moment i shkon një mendim:

- Këtu do ndërtoar sofate, ku të pushojnë njerëzit sa të mbushet uji, si dhe korita për të pirë ujë bagëtitë. Ai atë që mendonte do ta realizonte. Të nesërmen, bashkë me banorët e fshatit, iu përvesh punës dhe i realizoi. Tani, në atë vend është harruar kush e ndërtoi çezmën se vendi ka marrë tjetër emër dhe quhet: Te sofatet e Dervish Iliasit.

Dervishi kishte kohë që studjonte për ngritjen e fshatit dhe teqen në Kulmak. Ai kishte parë pelegrinazhit në vendet e Lindjes, kur ishte tri muaj me baba Ahmet Turanin e klerikë të tjerë. Siç dihet historikisht në Çukën e Tomorit u ngrit mekami i Abaz Aliut, një histori e tërë nga shekulli XIV. Ajo është ngritur mbi shpellën e të Mirëve, që ndodhet 600 m. poshtë Çukës Tomorit nga ana perëndimore. Pas periudhës otomane, mekami mbahej dhe ruhej prej bektashianëve, nga burimet historike shkruhet se është bërë ndërtimi i plotë me gurë në vitin 1880. Disa qindra metra poshtë majës, pranë një qafe, në 1908, ishte një dervishije e thjeshtë me dy dhoma, ku jetonte vetëm një dervish, e cila në vitin 1914, ajo u shkatërrua prej andartëve grekërve dhe dy vjet më vonë kur situata u qetësua, nën ndikimin e baba Ahmed Turanit (i teqesë së Turanit-Tepelenë) dervish Iljasi e ripërtëriu këtë qendër. Dervish Iliasi kishte njohuri për pelegrinazhin e hershëm në malin e Tomorit, jo vetëm njohje që në vegjëli kur prindërit e tij nga Vërzhezhja e çonin të mëkohej me hyjnëzimim në këtë mal, por edhe në Turqi, ai mori njohuri për pelegrinazhet në vendet e shenjta të lindjes, të cilat edhe i vizitoi, në Qerbela, Nexhef, në Egjipt dhe vizita me disa baballarë në vitin 1910 në vendet e shenjta të Lindjes: baba Ahmet Turani i Tepelenës, baba Sulejmani i teqesë Shtufit, dede Kamberi ishin prej tre muajsh në këto vende të shenjta. Teqeja është ndërtoar në një lëndinë të bukur, që nuk e rrahin erërat e forta të luginës (Stoçeni i Tomoricës) pasi ky vend i bukur i plotësonte disa kërkesa të domosdoshme të një objekti ndërtimi, për të jetuar, si dhe për të zhvilluar dhe veprimtari fetare. Lëndina kish një sipërfaqe rreth 2000 metra katror. Afër kish një burim uji, i cili ishte mbi nivelin e lëndinës dhe kjo bënte të mundur, që uji të qarkullonte lirshëm në teqe. Vendi është i mbrojtur nga rreziku i rënies së ortekëve të borës dhe nuk e rreh era e jugpërdimit. Dervish Iljasi me përvojën e ndërtimeve: në rrugët, pusët dhe çezmat, vendosi të ndërtonte teqenë në këtë lëndinë. Ai e ngriti me murë gurillaç gëlqereje mbuluar me rrasa guri, në traditë të ndërtimeve që përdorej në shekuj në Skrapar. Ky e ndërtoi teqen sipas parimeve bektashiane me element arkitekturor: kafe oxhaku, mejdani, ashefi, guzhina, salla e ngrënies, bëri dhe furrën e bukës, fjetore. Ndërtesa ka qënë një katëshe, në lindje kishte një dhomë në katin e dytë që quhej dhoma e babait (mejdani) Dhoma e Babait shërbente edhe si mejdan e përshkruan Joseph Swire (në librin Mbretëria Zog) "Dhoma e madhe në fund të saj dukeshin një konstruksion druri si një shkallë e gjërë lëvizëse me tri shkallë mbi të cilat digjeshin qirinj në shandanët e verdhë, në të djathtë mbuluar me sixhade, qëndronte babai dhe në të djathtë të tij ishte një kandidatë për dervish, mbi mur vareshin piktura të shënjtoreve bektashinj dhe një orë e madhe me pendul."

Dhomat ishin me dysheme dhe tavan, të veshur me dru pishe e stazhionuar në vite. Secila nga dhomat kishin oxhak për ngrohje. Ndërtesën e zinte dielli pothuajse gjatë treçerekut të ditës, mbasi ishte në krahun verior të Tomorit dhe plotësohshin gjithë ambientet me dritë. Me ngritjen e teqesë dhe shërbimet fetare që bëheshin çdo ditë nga dervish Iljasi, dita-ditës teqeja u kthye në një vend të mirë pritës, jepte shpresë të çdo vizitor i thjeshtë dhe besimtar, sa të gjithë kur ktheheshin në shtëpi thoshnin: - Kjo teqe, është e bekuar nga dervish Iljasi dhe ka sjellë dhe do të sjellë vetëm mbarësi për të gjithë njerëzit të çdo besimi e etnie.

// The World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, had impressive meetings in Paris, in the dates 7 – 10 October 2020

WE APPRECIATE YOUR EFFORTS FOR PEACE!

After the invitation of Mr. Jean-Christophe Peaucelle, Ambassador for Religious Issues in the Ministry for Europe and Foreign Affairs of France, in the spaces of this Ministry, the Delegation of the Bektashi Holy See, headed by the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, met the french friends. Apart the Ambassador Peaucelle, in this meeting was present also Mr. Thomas Bertin, Chief of

the Western Balkans Department of this institution. In his welcome speech, Mr. Peaucelle thanked the World Bektashi Grandfather for responding to his invitation and remembered their first meeting in Tirana, during a visit of Mr. Peaucelle in Albania in order to know, in situ, the religious harmony in our country.

The Ambassador Peaucelle said also that he knew the fact that the Bektashi Holy See, which was installed in Tirana since the year 1930, is transformed in an important factor of the unification of the Albanians in order to face the Balkan wars and to consolidate the coexistence and the religious harmony in the region. He remembered to the present people participating in this meeting, that the march of the Albanian religious leaders in the streets of Paris, five years ago, commemorating the victims of Charlie-Hebdo, was not only a touching ceremony but also a very significative one. Through this ceremony they transmitted the great message that the religious peace is completely possible and that the realities in which we live need the devotion of all of us.

Futher, the Ambassador Peaucelle demanded to know something more about the religious climate in Albania and about the role of the Bektashi Holy See. On his part, the World Bektashi Grandfather, after thanking the french friends for the invitation and for the warm hospitality, said that Albania enjoys of human and religious values leading the society to the unity and harmony. Since a long time ago, we, the religious leaders, educated and educate our followers the idea that is not possible the existence of "We and they". We are the same, apart the theories, the doctrines and the practices,



we pray to the Only God and this is the only mission of the religion, to encourage peace and fraternity and to keep away the rancours and quarrels. We try not only to preserve the fundamental values of the religious freedom, but also we work for their progress, in order to help democratic systems.

After, presenting the actual activity of the Bektashi Holy See, the World Bektashi Grandfather said, among others: The essence of our faith and our practices is the love for the man, for the human being, apart the race to which he belongs or the religion he follows. In the history of the tarikat (brotherhood) of Islam existed thousands of them who lost the way. We travelled during 800 years already and here we are today, full of hope for our mission, living everywhere, in all over the World and presenting everywhere wisdom and human love. Since several years, we have meetings with Greek and Turkish governors, in order that the tekkes of Haxhi Bektash Veli which are situated in the respective countries, outside the Albanian borders, to give back to their religious mission, to the mission educating the spirits with the holy knowledges. In the actual Turkey and Greece live tens of thousands of Bektashi people, who want to visit these temples of faith, for finding there force and hope, to pray there in silence, to have

the opportunity to meet there brothers and sisters of their tarikat that they love so much. We are sure that these historical tekkes will be reopened and so we will be more united – Turkish, Greek and Albanian people. Personally I hope so much in this future.

While Mr. Bertin put the question "Which is your attitude regarding the conflict, a religious one too, between Serbia and Kosova", the World Bektashi Grandfather answered: Historically our tarikat has been a binding bridge between the sunnit Moslems and the Christians. Besides the Balkan archives, there are many foreign authors and travellers who testified this fact; among them there are several french authors – Justin Godart, Louis Jarey, Natalie Clayer and others, who pointed out this precious Bektashi character. During the war between Kosova and Serbia was totally burnt by projectiles of the heavy artillery our tekke in Gjakovë. It was so painful to see how the flames devoured, in few minutes, the religious and cultural heritage dating more then 300 years. After that, the Bektashi Holy See declared: "They who burnt tekkes, mosques or Serbian churches, must be punished by the Law. The belief to God does not divide, does not disunite, does not burn or destroy - it only unite".



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.141 DHJETOR 2020



*Gjithë dashamirësve dhe
bashkëpunëtorëve të Urtësisë
Gëzuar 2021!*